



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 753  
Datë: 7 / 3 / 2024

**RREGULLORJA**

**PËR PROCEDURËN ZGJEDHORE, THEMELIMIN DHE PUNËN E  
PARLAMENTIT STUDENTOR DHE KËSHILLAVE TË STUDENTËVE TË  
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

Në bazë të nenit 158, paragrafi 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli Drejtues i  
Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, me datë 1.3.2024, miratoi:

## **RREGULLORE**

### **PËR PROCEDURËN ZGJEDHORE, THEMELIMIN DHE PUNËN E PARLAMENTIT STUDENTOR DHE KËSHILLAVE TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

## PËRMBAJTJA

<b>Kapitulli I</b> .....	5
<b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b> .....	5
Neni 1. Qëllimi, fushëveprimi dhe përkufizimet .....	5
Neni 2. E drejta për të themeluar organizata studentore .....	5
<b>Kapitulli II</b> .....	5
<b>PROCEDURA DHE RREGULLAT ZGJEDHORE PËR ORGANET PËRFAQËSUESE TË STUDENTËVE</b> .....	5
Neni 3. Përfaqësimi në organet qeverisëse .....	5
Neni 4. Parlamenti i Studentëve .....	6
Neni 5. Struktura e parlamentit të studentëve dhe mandatet .....	7
Neni 6. Këshillat e studentëve .....	8
Neni 7. Struktura e Këshillit të Studentëve dhe mandatet .....	8
Neni 8. Parimet zgjedhore për zgjedhjet e studentëve .....	9
Neni 9. Parimet e përfaqësimit dhe pragu zgjedhor .....	10
Neni 10. Kohëzgjatja dhe përfundimi i mandatit .....	10
Neni 11. Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve të studentëve .....	11
Neni 12. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ UP .....	12
Neni 13. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit - KZF .....	12
Neni 14. Kufizimet në procesin zgjedhor .....	13
Neni 15. Kryesuesi i KQZ-UP-së .....	14
Neni 16. Vëzhguesit në komisionin zgjedhor .....	14
Neni 17. Zëvendësimi i anëtarëve në KQZ-UP .....	14
Neni 18. Kuorumi dhe vendimmarrja në KQZ-UP dhe KZF .....	14
Neni 19. Thirrja e mbledhjes së KQZ-UP-së dhe KZF-së .....	15
Neni 20. Procesverbali i takimit të KQZ-UP-së dhe KZF-së .....	15
Neni 21. Thirrja e takimit të KZF-së .....	15
Neni 22. Përgjegjësitë e KQZ-UP-së dhe certifikimi i listave .....	15
Neni 23. Lista e studentëve me të drejtë vote .....	16
Neni 24. Lista e kandidatëve .....	17
Neni 25. Përmbajtja e listës së kandidatëve .....	18
Neni 26. Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve .....	18
Neni 27. Rregullsia e listës së kandidatëve .....	18
Neni 28. Tërheqja e kandidatëve nga lista .....	19
Neni 29. Afati i dorëzimit të listës së kandidatëve .....	19
Neni 30. Mbajtja e zgjedhjeve .....	19
Neni 31. Qasja në vendvotim .....	20
Neni 32. Mbrojtja e fshehtësisë së votës në vendvotim .....	20
Neni 33. Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor .....	21
Neni 34. Respektimi i procedurave zgjedhore .....	21
Neni 35. Mënyra e votimit fizike dhe online .....	21
Neni 36. Verifikimi i votuesve .....	21
Neni 37. E drejta e votës dhe gabimet në votim .....	22
Neni 38. Regjistrimi i votuesve me rastin e votimit .....	22
Neni 39. Mënyra e regjistrimit të votuesve .....	22
Neni 40. Qartësimi i identitetit të votuesit .....	23
Neni 41. Përmbajtja dhe formati i fletëvotimit .....	23
Neni 42. Vlefshmëria e fletëvotimit .....	23
Neni 43. Pavlefshmëria e fletëvotimit .....	23

Neni 44. Numërimi i votave dhe dorëzimi i rezultateve.....	24
Neni 45. Raporti i KZF për rezultatet e zgjedhjeve .....	24
Neni 46 .Pengimi i procesit të votimit .....	25
Neni 47. Shpërndarja e mandateve të fituara .....	25
Neni 48. Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve .....	26
Neni 49. Konfirmimi i mandatave.....	26
Neni 50. Ankimimi ndaj procesit zgjedhor .....	26
Neni 51. Përsëritja e procesit zgjedhor .....	27
<b>Kapitulli III.....</b>	<b>27</b>
<b>KONSTITUIMI I PARLAMENTIT,</b>	
<b>KËSHILLAVE TË STUDENTËVE DHE PUNA E TYRE.....</b>	<b>27</b>
Neni 52. Parimet e konstituimit të Parlamentit dhe këshillave të studentëve.....	27
Neni 53. Mandati dhe verifikimi i mandatit.....	29
Neni 54. Deklarata etike .....	30
Neni 55. Zgjedhja kryetarit dhe sekretarit të Parlamentit të Studentëve.....	30
Neni 56. Shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Parlamentit të Studentëve .....	31
Neni 57. Zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të Studentëve.....	32
Neni 58. Zgjedhja dhe shkarkimi i nënkryetarit të PS dhe nënkryetarit të KS .....	32
Neni 59. Mbledhjet e PS dhe KS .....	33
Neni 60. Pjesëmarrja në mbledhje dhe zëvendësimi.....	34
Neni 61. Konflikti i interesit .....	35
Neni 62. Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës të PS/KS .....	35
Neni 63. Ecuria e mbledhjes së PS/KS.....	36
Neni 64. Vendimmarrja, votimi dhe zgjedhja.....	36
Neni 65. Mbajtja e rendit në mbledhje e PS/KS.....	37
Neni 66. Shqiptimi i masave për mbajtjen e rendit në mbledhjet e PS/KS.....	37
Neni 67. Procesverbali nga mbledhja e KS / PS.....	37
Neni 68. Procedura e votimit të fshehtë.....	38
Neni 69. Rastet e votimit të fshehtë në PS .....	38
Neni 70. Rastet e votimit të fshehtë në KS .....	38
Neni 71. Nominimet e listës së kandidatëve për anëtar të Senatit nga KS .....	39
Neni 72. Zgjedhja e anëtarëve të Senatit nga Parlamenti i Studentëve .....	39
Neni 73. Komisionet e PS/KS.....	40
Neni 74. Raporti në mes të PS dhe KS .....	40
Neni 75. Raporti i PS dhe KS me organet e Universitetit/Fakultetit .....	40
Neni 76. Qasja ndaj resurseve të PS dhe KS.....	41
Neni 77. Sistemi elektronik i votimit.....	41
Neni 78. Zbatimi i rregullores.....	42
<b>Kapitulli IV .....</b>	<b>42</b>
<b>DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE .....</b>	<b>42</b>
Neni 79. Vlefshmëria, zbatimi dhe ndryshimi .....	42
Neni 80. Shfuqizimi .....	42
Neni 81. Hyrja në fuqi.....	43
<b>SHTOJCA 1.....</b>	<b>44</b>
<b>Skema zgjedhore e përfaqësimit të studentëve .....</b>	<b>44</b>

## Kapitulli I

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Qëllimi, fushëveprimi dhe përkufizimet

1. Kjo Rregullore përcakton procedurën, kriteret dhe aspektet e tjera të ndërlidura me organizimin e zgjedhjeve për anëtarët e parlamentit të studentëve dhe të këshillave të studentëve të fakulteteve, si dhe konstituimin e Parlamentit të Studentëve dhe këshillave të studentëve në fakultetet e UP-së, përfshirë edhe funksionimin e tyre, pas fillimit të mandatit.
2. Shkurtesat dhe përkufizimet që përdoren në këtë rregullore e kanë kuptimin si në vijim:
  - 2.1. UP - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina";
  - 2.2. KQZ UP - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina";;
  - 2.3. KZF - Komisioni Zgjedhor i Fakultetit;
  - 2.4. KF - Këshilli i Fakultetit;
  - 2.5. PS - Parlamenti i Studentëve;
  - 2.6. KS - Këshillat e studentëve;
  - 2.7. SEMS - Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve.

#### Neni 2

#### E drejta për të themeluar organizata studentore

1. Studentët aktivë sipas akteve juridike në fuqi të UP, kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'u përkasin të gjithë studentët e rregullt dhe me korrespondencë në studimet e nivelit baçelor, si dhe studentët e nivelit master.
2. Secila organizatë studentore duhet ta ketë statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj, në pajtim me këtë rregullore, si dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës që rregullon fushën e organizatave joqeveritare.
3. Statuti i organizatës studentore duhet t'i përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.
4. Organizatat studentore kanë të drejtë të garojnë me një listë të vetme ose të krijojnë koalicione parazgjedhore (para certifikimit) me organizata tjera studentore.

## Kapitulli II

### PROCEDURA DHE RREGULLAT ZGJEDHORE PËR ORGANET PËRFAQËSUESE TË STUDENTËVE

#### Neni 3

#### Përfaqësimi në organet qeverisëse

1. Interesat e studentëve do të përfaqësohen në Universitet përmes këtyre organeve:
  - 1.1. Parlamenti i Studentëve, në nivel të UP-së;

1.2. Këshillat e studentëve, në nivel të fakulteteve.

2. Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për Parlamentin e Studentëve dhe këshillat e studentëve të fakulteteve në bazë të rezultateve të zgjedhjeve dhe sipas mandateve të fituara që certifikohen nga KQZ UP.
3. Studentët të cilët kanë përsëritur vite të studimeve nuk kanë të drejtë të kandidohen, përkatësisht të zgjedhen në organet e përfaqësimit të studentëve.
4. Studentët e studimeve baçelor të cilët kanë notën mesatare më të ulët se shtatë pikë pesë (7.5) nuk kanë të drejtë të kandidohen për t'u zgjedhur në organet e përfaqësimit të studentëve.
5. Studentët e studimeve baçelor dhe master të cilët propozohen nga këshillat e studentëve për anëtarë të Senatit duhet të kenë notë mesatare jo më të ulët se tetë (8) në nivelin e studimeve baçelor, përkatësisht master.
6. Nëse nota mesatare e përfaqësuesit të zgjedhur të studentëve në organet përfaqësuese të studentëve, gjatë ushtrimit të mandatit bie nën shtatë pikë pesë (7.5) i njëjti nuk e humb mandatin e fituar në zgjedhje.
7. Studentët që janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike nuk kanë të drejtë të kandidohen në listat zgjedhore të organizatave studentore. Megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që studentët në forma të tjera të anëtarësisë të ushtrojnë aktivitetin e tyre bazuar në të drejtat civile dhe politike sipas konventave ndërkombëtare, Kushtetutës dhe legjislacionin në fuqi.
8. Studentit i cili e ka fituar mandatin për përfaqësim në organet e përfaqësimit të të studentëve, me rastin e diplomimit menjëherë i ndërpritet mandati i fituar. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës të renditur në listën e certifikuar të kandidatëve nga e njëjta organizatë studentore. Kjo vlen për të gjitha nivelet e përfaqësimit të studentëve, PS, KS dhe Senat.

#### **Neni 4**

#### **Parlamenti i Studentëve**

1. Parlamenti i Studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve, i cili merr vendime për çështjet studentore në nivel të UP-së.
2. Parlamenti i Studentëve zgjedh shtatë (7) anëtarë të Senatit. Nga kjo përbërje, kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar ex-officio, kurse gjashtë (6) anëtarë të tjerë propozohen nga këshillat e studentëve të fakulteteve.
3. Mandati i anëtarëve studentë të Senatit është një (1) vit. Studenti nuk mund ta ushtroj mandatin e senatorit më shumë se një (1) vit, me përjshim të rastit kur ky mandat ushtrohet ex-officio nga kryetari i Parlamentit të Studentëve, sipas Statutit.
4. Parlamenti i Studentëve vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe fokusohet në çështjet si në vijim:
  - 4.1. Interesat e studentëve në nivel të Universitetit dhe të drejtat e tyre siç përcaktohet në Statut;
  - 4.2. Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të Universitetit dhe zhvillimet

- akademike në interes të studentëve;
- 4.3. Përfshirja e studentëve në zhvillimin e cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit, në pajtim me Statutin;
  - 4.4. Organizimin e aktiviteteve edukative, kulturore e sportive; dhe
  - 4.5. Çështjet tjera të përgjithshme të interesave të studentëve.
5. Parlamenti i Studentëve ka kompetencat si në vijim:
- 5.1. Zgjedhjen e anëtarëve studentë në Senatin e UP-së;
  - 5.2. Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të UP-së;
  - 5.3. Propozimet për Senatin e UP-së në lidhje me çështjet studentore dhe akademike të ndërlidhura me interesin e studentëve;
  - 5.4. Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e fakulteteve dhe Universitetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit;
  - 5.5. Çështjet tjera që përcaktohen nga Parlamenti i Studentëve, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e UP-së.
6. Parlamenti i Studentëve, për realizimin e aktiviteteve të tyre, në interes të studentëve dhe të UP-së mund të kërkojë mbështetje financiare dhe logjistike nga Këshilli Drejtues i UP-së, duke u bazuar në kërkesa të arsyetuara të aktiviteteve dhe në pajtim me mundësitë buxhetore.

## **Neni 5**

### **Struktura e Parlamentit të Studentëve dhe mandatet**

1. Parlamenti i Studentëve përbëhet nga numri i tërësishëm i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve, i cili është shtatëmbëdhjetë (17).
2. Anëtarët e Parlamentit të Studentëve propozohen nga organizatat studentore, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
3. Ndarja e mandateve për Parlamentin e Studentëve bëhet varësisht nga numri i përgjithshëm i përqindjes së votave që arrihet gjatë zgjedhjeve sipas Statutit dhe kësaj rregulloreje, me kusht që organizatat që fitojnë mandatin në Parlamentin e Studentëve të kenë kaluar pragun e nevojshëm prej 5%.
4. Votat e organizatave studentore të cilat nuk kanë arritur pragun prej 5% të numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e Studentëve, nuk do të shpërndahen në organizatat tjera të kualifikuara për përfaqësim në Parlament të Studentëve.
5. Anëtarët e Parlamentit të Studentëve zgjedhin kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin.
6. Zgjedhjet e Parlamentit të Studentëve udhëhiqen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
7. KQZ UP emërohet nga Këshilli Drejtues i UP-së me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe ka mandat katër (4) vjeçar të funksionimit..
8. Pas përfundimit të zgjedhjeve studentore, përgjegjës sipas detyrës zyrtare përkitazi me zbatimin e kësaj rregulloreje për funksionimin dhe ushtrimin e mandatit të Parlamentit të Studentëve është KQZ UP, respektivisht KZF përkatëse.

## **Neni 6 Këshillat e studentëve**

1. Këshillat e studentëve janë organe të përfaqësimit të studentëve në fakultete.
2. Secili Këshill i studentëve propozon listën me tre (3) kandidatë për anëtarë studentë të Senatit për t'u zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve, sipas Statutit dhe kësaj rregulloreje.
3. Këshilli i studentëve i fakultetit zgjedh një (1) anëtar student për Këshill të Fakultetit nga radhët e studentëve që kanë fituar mandat në zgjedhjet studentore për KS. Kryetari i Këshillit të Studentëve është anëtar ex-officio nga numri i përgjithshëm prej dy (2) anëtarëve studentë të Këshillit të Fakultetit.
4. Anëtarët e Këshillit të Studentëve zgjedhin kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin, ashtu siç është përcaktohet në këtë rregullore.
5. Këshilli i Studentëve kujdeset për çështjet si në vijim:
  - 5.1. Përfaqëson dhe kujdeset për promovimin dhe mbrojtjen e interesave të studentëve në nivel të fakultetit, duke pasur parasysh të drejtat e studentëve të përcaktuara në Statutin e UP-së;
  - 5.2. Së bashku me strukturat përgjegjëse të Fakultetit angazhohet për cilësi në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke pasur parasysh të drejtat e studentëve tyre të përcaktuara me Statut;
  - 5.3. Së bashku me strukturat përgjegjëse të Fakultetit merr pjesë në zhvillimin e cilësisë së mësimit dhe të vlerësimit, sipas Statutit;
  - 5.4. Kujdeset edhe për çështje tjera të lidhura me të drejtat e studentëve, siç përcaktohen me Statuti.
6. Këshilli i Studentëve merr vendime për çështjet si në vijim:
  - 6.1. Përgatitjen e listës së ngushtë për anëtarët studentë të Senatit, sipas dispozitave të Statutit dhe kësaj rregulloreje;
  - 6.2. Zgjedhjet e anëtarëve studentë në Këshill të Fakultetit;
  - 6.3. Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të Fakultetit që lidhen me të drejtat e studentëve, sipas Statutit;
  - 6.4. Propozimet për këshillin e fakultetit lidhur me çështjet që lidhen me të drejtat e studentëve të cilat janë të përcaktuara në Statutin e UP-së;
  - 6.5. Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe Këshillin e Fakultetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit.
7. Këshilli i Studentëve të Fakultetit nuk mund të ndërmarrë veprime dhe t'i bëjë njësisë akademike propozime për çështje të cilat janë jashtë mandatit të tyre dhe që nuk përfshijnë të drejtat e studentëve, siç përcaktohet me Statutin e UP-së. Për nismat që kanë të bëjnë me nivelin qendror, KS duhet të konsultohet me PS.

## **Neni 7 Struktura e Këshillit të Studentëve dhe mandatet**

1. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Studentëve është 1% i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë fakultet. Këshilli i studentëve ka më së paku pesë (5) dhe më së shumti njëzet e një (21) anëtarë.



2. Anëtarët e Këshillit të Studentëve propozohen nga organizatat studentore, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura gjatë zgjedhjeve të studentëve për fakultet sipas renditjes në listat e kandidatëve, të publikuara nga organizata studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
3. Ndarja e mandateve për Këshillin e Studentëve të Fakultetit, për secilën organizatë studentore që certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje, varet nga totali i përqindjes së votave të arritura gjatë zgjedhjeve sipas Statutit dhe kësaj rregulloreje.
4. Votat e organizatave studentore të cilat nuk kanë arritur pragun prej 3% të numrit të përgjithshëm të votave për Këshill të Studentëve, nuk do të shpërndahen në organizatat tjera të kualifikuara për përfaqësim në Këshill të Studentëve.
5. Zgjedhjet për këshilla të studentëve do të udhëhiqen nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit (KZF) përkatës në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ UP).

## **Neni 8**

### **Parimet zgjedhore për zgjedhjet e studentëve**

1. Organizatat studentore që pretendojnë të marrin pjesë në zgjedhjet studentore duhet të jenë të regjistruara dhe t'i plotësojnë të gjitha kriteret e tjera, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Regjistrimi i organizatave të reja studentore do të bëhet në Ministrinë përkatëse të Administratës Publike, sipas Ligjit në fuqi për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
3. Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si "shoqatë" – "asociacion" në Ministrinë përkatëse të Administratës Publike, sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara, ndërsa themelimi i organizatave të reja duhet të regjistrohen më së largu njëzet (20) ditë para datës së votimit në zgjedhjet e shpallura, sipas kësaj rregulloreje.
4. Organizatat studentore kanë të drejtë të regjistrohen për:
  - 4.1. Përfaqësim të përgjithshëm të studentëve të Universitetit;
  - 4.2. Përfaqësim të studentëve në fakultete individualisht.
5. Organizata studentore për t'u certifikuar për herë të parë, për pjesëmarrje në zgjedhje studentore duhet t'i sigurojë së paku 1800 nënshkrime mbështetëse nga studentët në të gjithë UP-në, përmes deklaratave mbështetëse.
6. Në deklaratën mbështetëse për certifikim të organizatës duhet të shënohen: emri dhe mbiemri, numri i ID-kartelës së studentit ose indeksit, numri personal, fakulteti dhe nënshkrimi origjinal i studentit.
7. I njëjti student nuk mund ta plotësojë deklaratën mbështetëse për dy organizata studentore të ndryshme, që pretendojnë të certifikohen për pjesëmarrje në zgjedhjet studentore për herë të parë.

8. Në rast se konstatohen parregullsi ose falsifikim me rastin e plotësimit të shënimeve në listat mbështetëse, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, largon nga lista mbështetëse emrin e kandidatit/es i cili gjendet edhe në lista të tjera dhe merren masa ligjore kundër tij/saj në pajtim me legjislacionin në fuqi.
9. Listat mbështetëse përveç në lidhje të fortë fizike duhet të dorëzohen në KQZUP edhe në formë elektronike (Excel), në emailin zyrtar të KQZ UP.
10. Data kualifikuese për organizatat studentore, për të fituar të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet studentore, do të caktohet pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së votimit në zgjedhjet studentore. Procesi i regjistrimit dhe licencimit duhet të përfundojë më së largu në atë datë.

### **Neni 9**

#### **Parimet e përfaqësimit dhe pragu zgjedhor**

1. Anëtarët e Parlamentit të Studentëve dhe këshillave të studentëve do të zgjedhen në pajtim me procedurat e Statutit dhe të kësaj rregulloreje, ndërsa për rastet të cilat nuk janë rregulluar në Statut dhe këtë rregullore, përshtatshmërisht vlejné dispozitat për zgjedhjet e përgjithshme në nivel të Republikës së Kosovës.
2. Përfaqësimi i studentëve në Parlamentin e Studentëve dhe këshillat e studentëve bëhet në bazë të numrit të votave të arritura, për Parlamentin e Studentëve dhe këshillat e studentëve.
3. Gjatë zgjedhjeve studentore për parlament dhe këshilla të studentëve do të aplikohet sistemi i përfaqësimit proporcional. Kjo siguron që secila organizatë studentore që ka fituar numrin e përgjithshëm të votave mbi prapun përkatës të arritur, do të fitojë numrin e ulëseve në proporcion me përqindjen e votave të cilat i kanë marrë në zgjedhjet studentore në të dyja nivelet.
4. Pragu për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:
  - 4.1. Pesë përqind (5%) i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e Studentëve;
  - 4.2. Tre përqind (3%) i numrit të përgjithshëm të votave në nivel të fakultetit përkatës për këshillat e studentëve në fakultet.

### **Neni 10**

#### **Kohëzgjatja dhe përfundimi i mandatit**

1. Mandati i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve dhe i Këshillit të Studentëve të Fakultetit zgjat dy (2) vjet, pa të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat në nivelin e njëjtë të përfaqësimit.
2. Mandati i përfaqësuesit të zgjedhur në Parlamentin e Studentëve ose në Këshill të Fakultetit përfundon para kohe në rastet si në vijim:
  - 2.1. Me rastin e dorëheqjes;
  - 2.2. Me rastin e diplomimit të studentit të zgjedhur, në nivelin e studimeve që ka fituar mandatin;
  - 2.3. Me rastin e humbjes së statusit të studentit që ka fituar mandatin;

- 2.4. Në rast të shqiptimit të masës disiplinore për shkelje të rënda, me vendim të organeve kompetente për shqiptimin e masave disiplinore në nivel të Fakultetit dhe të Universitetit.;
  - 2.5. Në rast të ngritjes së aktakuzës apo dënimit për vepër penale.
3. Procedura e përfundimit të parakohshëm të mandatit të përfaqësuesit të studentëve në Parlamentin e Studentëve dhe këshillat e studentëve zbatohet nga KQZ UP për PS dhe KZF për këshillat e studentëve.

### Neni 11

#### Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve të studentëve

1. Zgjedhjet e studentëve shpallen nga Këshilli Drejtues i UP-së.
2. Zgjedhjet e studentëve mund të mbahen në mënyrë fizike si dhe online.
3. Organizatat studentore mund t'i parashtrojnë Këshillit Drejtues, si organ vendimmarrës i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kërkesë lidhur me mënyrën e mbajtjes së zgjedhjeve. Këshilli Drejtues analizon kërkesat e organizatave studentore dhe varësisht nga rrethanat objektive dhe të tjera nxjerr vendim përfundimtar.
4. Zgjedhjet e studentëve mbahen jo më larg se njëzet e pesë (25) ditë nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues për shpalljen e zgjedhjeve të studentëve.
5. Data e saktë e zgjedhjeve të studentëve përcaktohet nga Këshilli Drejtues i UP-së.
6. Organizatat studentore të cilat certifikohen për të marrë pjesë në zgjedhjet studentore në nivel Universiteti apo Fakulteti, duhet të mbajnë fushatë bazuar në renditjen e listës së kandidatëve, gjithnjë duke respektuar Statutin dhe këtë rregullore.
7. Periudha e fushatës zgjedhore për organizatat e studentëve do të fillojë në ditën e parë pas certifikimit të organizatave studentore për pjesëmarrje në zgjedhje.
8. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së votimit, duke e llogaritur kohën që nga ora 00:00 e ditës së parë pas certifikimit të organizatave studentore për pjesëmarrje në zgjedhje. Zgjedhjet do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa do të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë tjera të interesit për monitorim të zgjedhjeve. Nga momenti i përfundimit të fushatës zgjedhore, konsiderohet se fillon heshtja zgjedhore.
9. Shkeljet e rregullave dhe procedurave zgjedhore si dhe shkelja e heshtjes zgjedhore do të sanksionohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Këshilli Drejtues, si shkallë e dytë në këtë proces.
10. KQZ UP në rastin e shkeljeve nga organizatat studentore mund të shqiptojë sanksionet si vijon:
  - 10.1. Largimin nga listat zgjedhore të kandidatëve që bëjnë shkelje;
  - 10.2. Largimin nga gara zgjedhore të organizatës studentore, në rast se shkeljet janë si rezultat i sjelljeve të organizatës studentore ose kandidatit, në rast se shkeljet janë si rezultat i sjelljeve të kandidatit.

## **Neni 12** **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ UP**

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushë obligimet e veta, sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe rregulloreve në fuqi.
2. Komisioni Qendror Zgjedhor emërohet nga Këshilli Drejtues, me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme. KQZ UP është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të përgjithshme të UP-së, përfshirë edhe zgjedhjet studentore.
3. KQZ UP përbëhet nga dy (2) profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në UP dhe sekretari i përgjithshëm i UP-së. Kryesuesi i KQZ-së duhet të jetë nga fusha e drejtësisë, anëtari tjetër nga radhët e profesorëve, i cili me automatizëm është zëvendëskryesues, kurse sekretari i përgjithshëm i UP-së është sekretar i KQZ UP-së. Në cilësinë e vëzhguesit, pjesë e KQZ UP-së është edhe një person nga KQZ UP e Republikës së Kosovës. Për zgjedhjet studentore, nga një përfaqësues prej të gjitha organizatave të studentëve, të cilat janë të certifikuar për zgjedhje, në cilësinë e vëzhguesit, pa të drejtë vote.
4. Kryesuesi i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve thërret mbledhjen konstituive dhe udhëheqë KQZ-UP-në.
5. KQZ UP zgjidhet me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe ka mandat katër (4) vjeçar të funksionimit.
6. KQZ-UP duhet të dërgojë kërkesë me shkrim për të marrë emrat e nominuar nga organizatat studentore që kanë të drejtë të përfaqësohen në KQZ UP.
7. KQZ UP-ja është përgjegjëse për përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore.
8. Rezultatet e zgjedhjeve studentore shpallen nga KQZ-UP-ja.
9. KQZ UP duhet t'i aprovojë udhëzimet për votim me propozim të kryesuesit të komisionit, brenda shtatë ditëve (7) pas konstituimit.

## **Neni 13** **Komisioni Zgjedhor i Fakultetit - KZF**

1. Këshillat e fakulteteve të UP-së, themelojnë Komisionin Zgjedhor të Fakultetit, brenda tri ditëve (3) pas shpalljes së zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues.
2. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përbëhet nga tre anëtarë:
  - 2.1. Sekretari i fakultetit, kryesues i komisionit zgjedhor ex officio;
  - 2.2. Dy (2) anëtarë nga personeli akademik i fakultetit, nga të cilët të paktën një (1) profesor, të nominuar nga këshilli i fakultetit;
  - 2.3. Për zgjedhjet studentore, nga një përfaqësues prej të gjitha organizatave të studentëve, të cilat janë të certifikuar për zgjedhje, në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote.
3. Zgjedhja e anëtarëve të KZF-së bëhet me shumicë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit, përmes votimit të hapur.

4. Procesverbalet e komisionit të zgjedhjeve hartohen dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZF-së.
5. Mbledhjet e komisionit zgjedhor të fakultetit thirren nga kryesuesi i KZF-së dhe mund të mbahen në mënyrë fizike dhe përmes platformave online.
6. KZF-ja është përgjegjëse për të zbatuar dinamikën zgjedhore të miratuar nga KQZ UP, në nivel të veprimeve zgjedhor në njësinë akademike.
7. KZF-të zgjidhen me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe kanë mandat katër (4) vjeçar të funksionimit.
8. Vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të KZF-së nga Këshilli i Fakultetit, duhet t'i dorëzohet KQZ UP-së para se të mbahet takimi konstituiv i KZF-së.
9. KQZ UP e përkrah dhe udhëzon KZF-në në përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore në fakultetin përkatës.

#### **Neni 14** **Kufizimet në procesin zgjedhor**

1. Asnjë student nuk mund t'i përfaqësojë interesat e studentëve në më shumë se një organ përfaqësues në nivel të Universitetit apo Fakultetit brenda mandatit përkatës, përfshirë edhe komisionet ku përfaqësohen studentët.
2. Asnjë student nuk ka të drejtë që emri i tij të jetë në më shumë se një listë të kandidatëve, në nivel të Universitetit apo Fakultetit përkatës.
3. Studenti që është i zgjedhur dhe ka fituar mandat në një organ përfaqësues të studentëve është i detyruar ta kryej detyrën e tij/saj në mënyrë të pavarur.
4. Të gjithë anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të Komisioneve Zgjedhore të Fakultetit duhet të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim (deklarata etike nën betim), e cila përgatitet nga kryesuesi i KQZ-UP-së. Kjo deklaratë në përmbajtjen e saj përcakton se anëtarët e KQZ-UP dhe KZF do të punojnë gjatë mandatit të tyre me përpikëri, në mënyrë të pavarur, paanshme dhe me përgjegjësi të lartë etike.
5. Këshilli Drejtues ka të drejtë që t'i suspendojë anëtarët studentë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit, me rekomandim të kryesuesit të komisionit zgjedhor (KQZ UP apo KZF), në rast të ndonjë shkelje të argumentuar me prova të dispozitave të kësaj rregulloreje nga anëtarët përkatës. Në këtë rast pozita nuk do të plotësohet për periudhën gjatë suspendimit.
6. Studenti/ja i cili ka fituar mandat në organet përfaqësuese të studentëve dhe në ndërkohë ka humbur statusin e studentit në fakultetin përkatës, ose ka diplomuar në atë fakultet nuk ka të drejtë të kandidojë për përfaqësim në të njëjtin organ, nëse ka regjistruar një fakultet tjetër brenda UP-së.

## **Neni 15** **Kryesuesi i KQZ-UP-së**

1. Kryesuesi i KQZ UP-së është përgjegjës për:
  - 1.1. Thirrjen e takimeve të KQZ UP;
  - 1.2. Udhëheqjen e takimeve;
  - 1.3. Udhëzimin për procesin e vendimmarrjes;
  - 1.4. Ekzekutimin e vendimeve të KQZ UP;
  - 1.5. Koordinimin e komisioneve të fakulteteve.
2. Kryesuesit të KQZ UP-së i caktohet një bashkëpunëtor profesional që do ta ndihmojë në kryerjen e punëve teknike dhe përgatitjen e procesverbaleve dhe çështjeve të tjera.
3. Këshilli Drejtues është i obliguar që të ofrojë mbështetje të mjaftueshme administrative për kryesuesin e KQZ UP-së, në mënyrë që t'i përmbushë obligimet e përcaktuara me këtë Rregullore.
4. Këshilli i Fakultetit përkatës është i obliguar që të ofrojë mbështetje të mjaftueshme administrative për kryesuesin e KQZ-UP-së, në mënyrë që t'i përmbushë obligimet e përcaktuara me këtë Rregullore.
5. Nëse kryesuesi i KQZ UP mungon në takime, përgjegjësitë sipas paragrafit (1) të këtij neni i ushtron zëvendës kryesuesi.

## **Neni 16** **Vëzhguesit në komisionin zgjedhor**

1. Secila organizatë studentore që certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhjet e studentëve sipas kësaj rregulloreje, ka të drejtë të nominojë një vëzhgues në KQZ UP apo në KZFF.
2. Nominimi i vëzhgueseve duhet të bëhet më së largu tri ditë (3) pas certifikimit të organizatave studentore për pjesëmarrje në zgjedhje.
3. Lista e vëzhguesve të nominuar duhet t'i dorëzohet KQZ UP-së, e protokolluar.

## **Neni 17** **Zëvendësimi i anëtarëve në KQZ UP**

Në rast të dorëheqjes së anëtarit të KQZ UP-së, Këshilli Drejtues duhet të zëvendësojë anëtarët e dorëhequr brenda njëzet e katër (24) orëve, sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.

## **Neni 18** **Kuorumi dhe vendimmarrja në KQZ UP dhe KZFF**

1. Në KQZ UP dhe KZFF konsiderohet se ekziston kuorumi, në rast se në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve, sipas kësaj rregulloreje.
2. Në rast se mungon kuorumi për mbajtjen e takimit, kryesuesi mund të thërras një takim tjetër brenda njëzet e katër (24) orësh.

3. Vendimet e KQZ UP-së dhe KZF-së merren me shumicë votash, kurse në raste tjera siç parashihet me këtë rregullore.
4. Në rast të votimit të barabartë, vota e kryesuesit të KQZ UP-së apo KZF-së është vendimtare.

#### **Neni 19**

##### **Thirrja e mbledhjes së KQZ UP-së dhe KZF-së**

1. Kryesuesi obligohet që ta ftojë mbledhjen e KQZ UP-së në afatin e paraparë sipas kësaj rregulloreje, e më së voni njëzet e katër (24) orë pasi të njoftohen për rastin përkatës.
2. Thirrja (ftesa) duhet t'i dorëzohet anëtarëve, përmes emailit zyrtar apo mjeteve të tjera të përshtatshme të komunikimit elektronik, e më së voni një (1) ditë para takimit. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës, si dhe vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit.
3. KQZ-UP mund të mbajnë mbledhje me prezencë fizike ose online.

#### **Neni 20**

##### **Procesverbali i takimit të KQZ UP-së dhe KZF-së**

1. Procesverbali duhet të përgatitet për çdo takim të KQZ UP-së dhe të KZF-së.
2. Procesverbali duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të takimit dhe të vendimeve që janë marrë. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga kryesuesi i KQZ UP-së, përkatësisht KZF-së.
3. Të gjitha procesverbalet e takimeve nga KQZ UP dhe KZF, duhet të ruhen nga kryesuesi i KQZ UP-së dhe i KZF-së.
4. Nga një kopje e procesverbalit për secilin takim duhet t'i jepet sekretarit të përgjithshëm të UP-së dhe duhet të ruhet në arkivin e UP-së për një periudhë prej tri (3) vjetësh.

#### **Neni 21**

##### **Thirrja e takimit të KZF-së**

1. Takimi i KZF-së duhet të thirret nga kryesuesi i KZF-së, sipas nevojës edhe më herët, por më së largu njëzet e katër (24) orë pas paraqitjes së çështjes.
2. Thirrja (ftesa) duhet t'i dorëzohet anëtarëve, përmes emailit zyrtar apo mjeteve të përshtatshme të komunikimit elektronik, e më së voni një ditë para takimit. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës, si dhe vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit.
3. KZF mund të mbajë mbledhje me prezencë fizike ose online.

#### **Neni 22**

##### **Përgjegjësitë e KQZ UP-së dhe certifikimi i listave**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në raport me zgjedhjet studentore, ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. Përcaktimin dhe zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve;
  - 1.2. Përgatitjen e listave për zgjedhje të studentëve me të drejtë zgjedhjeje;

- 1.3. Nxjerrjen e vendimit rreth kundërshtimeve kundër listës së kandidatëve;
  - 1.4. Certifikimin e organizatave për pjesëmarrje në zgjedhje;
  - 1.5. Konstatimin e numrit të përgjithshëm të mandateve;
  - 1.6. Vlerësimin e listës së kandidatëve;
  - 1.7. Kryesimin e procedurave zgjedhore;
  - 1.8. Identifikimin e listave përfundimtare të votuesve, sipas propozimit të KZF-së;
  - 1.9. Konstatimin e rezultateve të zgjedhjeve;
  - 1.10. Shqiptimin e sanksioneve për organizatat studentore;
  - 1.11. Dhënien e mandatit për t'i pranuar organizatat dhe kandidatët e zgjedhur;
  - 1.12. Informimin e kandidatëve;
  - 1.13. Shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve;
  - 1.14. Certifikimin e mandateve;
  - 1.15. Zëvendësimin e mandatit;
  - 1.16. Konstituimin e Parlamentit të Studentëve;
  - 1.17. Koordinimin e komisioneve zgjedhore të fakulteteve për konstituimin e këshillave të studentëve;
  - 1.18. Anulimin e zgjedhjeve në rast të parregullësive zgjedhore, të dëshmuara me prova;
  - 1.19. Ndërmarrjen e veprimeve dhe nxjerrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e dinamikës zgjedhore të KQZ UP.
2. Listat e organizatave të pranura të studentëve shpallen publikisht, më së voni katërbëdhjetë (14) ditë para ditës së zgjedhjeve, të njëjtat si përfundimtare dërgohen në KQZ UP më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve. KQZ UP-ja merr vendimin për certifikimin e këtyre listave.
  3. Listat e kandidatëve të propozuar nga organizatat studentore dhe të verifikuara nga KQZ UP-ja shpallen publikisht më së voni shtatë (7) ditë para ditës së zgjedhjeve.
  4. Rezultatet e zgjedhjeve shpallen publikisht brenda pesë (5) ditëve pas ditës së zgjedhjeve. Mandatet e arritura ndahen jo më vonë se shtatë (7) ditë pas ditës së zgjedhjeve.
  5. KQZ UP shpall dinamikën zgjedhore, më së largu një (1) ditë pas konstituimit të saj. Afatet e përcaktuara në dinamikën zgjedhore janë të obligueshme për të gjitha organizatat studentore dhe të njëjtat duhet të respektohen. Secili veprim i ndërmarrë jashtë dinamikës zgjedhore është i pavlefshëm.

### **Neni 23**

#### **Lista e studentëve me të drejtë vote**

1. Administrata Qendrore e UP-së dhe shërbimi i studentëve të fakultetit janë të obliguar t'ia sigurojnë KQZ-UP-së listën me të gjitha të dhënat e studentëve që kanë të drejtë vote, më së voni shtatë (7) ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të studentëve nga Këshilli Drejtues.
2. Në listën e studentëve me të drejtë vote, e cila përgatitet nga Administrata Qendrore duhet të përfshihen vetëm studentët aktivë, të cilët kanë regjistruar të paktën semestrin dimëror të vitit akademik përkatës, në të cilin mbahen zgjedhjet studentore.



3. Lista e studentëve me të drejtë vote duhet të bëhet publike dhe të jetë e qasshme për KQZ UP-në dhe studentët brenda shtatë (7) ditëve, pas shpalljes së zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues.
4. Listat finale të studentëve me të drejtë vote do të publikohen jo më vonë se dhjetë (10) ditë para datës së zgjedhjeve.
5. Brenda periudhës nga publikimi i listave, sipas paragrafit 4 të këtij neni, secili student ka të drejtë të ankohet kundër përmbajtjes së listës përmes ankesës së përpiluar me shkrim e cila i mund t'i parashtrohet KQZ UP-së.
6. Ankesat kundër listës së studentëve me të drejtë vote mund të paraqiten më së voni tri (3) ditë pas shpalljes së listave, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Lidhur me ankesat, KQZ UP vendos, brenda njëzet e katër (24) orëve pas pranimit të ankesës. Vendimi i KQZ UP në lidhje me ankesën është përfundimtar në procedurë administrative.

#### **Neni 24**

#### **Lista e kandidatëve**

1. Organizatat e studentëve me të drejtë pjesëmarrje në zgjedhje për Parlament të studentëve apo këshilla të studentëve sipas kësaj rregulloreje, duhet t'i dorëzojnë listat e kandidatëve në KQZ UP, përmes postës elektronike, më së voni një (1) ditë para datës së zgjedhjeve, duke përdorur formularin e Listës së Kandidatëve, ashtu siç është përcaktuar nga KQZ UP. Me rastin e dorëzimit të listave në KQZ UP, listat nuk mund të ndryshohen dhe/apo të plotësohen me kandidatë të rinj.
2. Secila listë e kandidatëve duhet të përmbajë:
  - 2.1. Emrin e organizatës së studentëve, e certifikuar në zgjedhje;
  - 2.2. Organin qeverisës që do të zgjedhet (Parlamentin e Studentëve apo Këshillin e Studentëve);
  - 2.3. Listën e kandidatëve sipas renditjes;
  - 2.4. Deklaratën e pëlqimit të kandidatëve;
  - 2.5. Personin e autorizuar të organizatës studentore, i cili duhet të ketë statusin e studentit.
3. Në rast se në listat e kandidatëve për Parlament të Studentëve dhe këshilla të studentëve, kandidaturat janë të njëjta, në dy apo më shumë organizata studentore, KQZ UP-ja duhet të kërkojë nga kandidatët që të deklarojnë se cilën organizatë do ta përfaqësojnë në zgjedhje, së paku katërmëdhjetë (14) ditë para datës së zgjedhjeve. Në rast se kandidatët nuk deklarojnë brenda këtij afati, rreth përfaqësimit të organizatës përkatëse, KQZ UP-ja vendos që të njëjtit t'i heq nga lista e kandidimit të të gjitha organizatave ku ata përfaqësohen.
4. Organizatat studentore, të cilat kanë qenë të përfaqësuara edhe më parë në përfaqësimin e studentëve të UP-së, do të kenë të drejtën t'i mbajnë emrat e tyre, me të cilat kanë garuar në të kaluarën.
5. Listat e dorëzuara të kandidatëve nuk mund të ndryshohen pas dorëzimit të tyre në KQZ UP.

6. Përdorimi i emrave të partive politike ekzistuese të Republikës së Kosovës, si emra të organizatave të studentëve nuk lejohet.

### **Neni 25**

#### **Përmbajtja e listës së kandidatëve**

1. Lista e kandidatëve të organizatave studentore duhet të përbëhet prej minimumit, sa dyfishi i mandateve të lejuara që të zgjidhet një organ përfaqësues, Parlament ose këshilla të studentëve, sipas kësaj rregulloreje. Nëse lista e organizatave studentore nuk përpilohet sipas përmbajtjes së përcaktuar në këtë paragraf, përgjegjësinë për efektet e mëtutjeshme në procesin zgjedhor e merr organizata studentore përkatëse.
2. Asnjë student që nuk figuron në listën e kandidatëve të publikuar nga KQZ UP-ja, nuk mund të fitojë mandat në Parlamentin e Studentëve apo në Këshill të Studentëve.
3. Kandidatët të cilët kandidojnë për përfaqësim në organet përfaqësuese të studentëve duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriterin e notës mesatare sipas kësaj rregulloreje.
4. Në mënyrë që kandidatura e tij/saj të jetë e ligjshme, kandidatët duhet të ofrojnë të dhënat si në vijim:
  - 4.1. Emri dhe Mbiemri;
  - 4.2. Vendi i lindjes;
  - 4.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
  - 4.4. Adresa;
  - 4.5. Fakulteti;
  - 4.6. Numri i indeksit të studentit apo ID kartelës;
  - 4.7. Dëshmia e regjistrimit të studentit të rregullt, e gjeneruar nga SEMS;
  - 4.8. Deklarata e pëlqimit.
5. Kandidatët të cilët nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara me këtë rregullore, të cilat përcaktojnë mënyrën e ushtrimit të drejtës së votës, përfshirë këtu edhe kriterin e notës mesatare, KQZ UP-ja ex-officio i largon nga lista e kandidatëve.
6. Verifikimi i dëshmimeve të paraqitura, sipas këtij neni bëhet nga njësitë akademike, respektivisht nga ana e KZF-ve.

### **Neni 26**

#### **Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve**

1. Në listën e kandidatëve për parlamentin dhe këshillat e studentëve, çdo i treti kandidat duhet të jetë femër.
2. Për detaje tjera të përfaqësimit gjinor të listës së kandidatëve, KQZ UP-ja i referohet Ligjit në fuqi për Barazi Gjinore dhe legjislacionit tjetër relevant, të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

### **Neni 27**

#### **Rregullsia e listës së kandidatëve**

1. Vlefshmëria e listës së kandidatëve duhet të kontrollohet nga KQZ UP-ja, pas dorëzimit të listës finale nga Organizatat Studentore, sipas afateve të kësaj rregulloreje.

2. Në rast të parregullsive të evidentuara nga KQZ UP-ja të listës së kandidatëve, lista i kthehet përfaqësuesit të organizatës studentore për përmirësim, sipas vërejtjeve të dhëna nga KQZ UP.
3. Lista e përmirësuar e kandidatëve, pas tërheqjes së tyre duhet të dorëzohet te KQZ UP nga organizata studentore, më së voni katërmëdhjetë (14) ditë para zgjedhjeve.
4. Nëse lista zgjedhore apo lista e kandidatëve, e cila është kthyer për përmirësim, nuk dorëzohet brenda periudhës kohore të caktuar, lista e kandidatëve e organizatës përkatëse studentore konsiderohet e tërhequr.

#### **Neni 28**

##### **Tërheqja e kandidatëve nga lista**

1. Secila organizatë studentore ka të drejtë të tërheqë kandidaturën e saj përmes deklaratës me shkrim, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i organizatës studentore, më së voni shtatë (7) ditë para ditës së votimit.
2. Kandidatura e organizatës studentore do të konsiderohet e tërhequr, nëse numri i kërkuar i kandidatëve sipas kësaj rregulloreje nuk është zëvendësuar, për arsye se kandidatët kanë tërhequr kandidaturën me shkrim dhe përmes deklaratës së nënshkruar, më së voni shtatë (7) ditë para zgjedhjeve.

#### **Neni 29**

##### **Afati i dorëzimit të listës së kandidatëve**

1. Lista zgjedhore apo lista e kandidatëve e cila nuk dorëzohet brenda periudhës së caktuar me këtë rregullore, nuk pranohet nga KQZ UP.
2. Lista e kandidatëve duhet të dorëzohet personalisht nga personi i autorizuar i organizatës në kopje fizike dhe elektronike.
3. KQZ UP duhet të aranzhojë në periudhën para zgjedhjeve një fushatë informuese përmes fletushkave ose në formë elektroinike për studentët me të drejtë vote, duke i informuar për procedurat zgjedhore. Këshilli Drejtues është i obliguar të ofrojë resurset e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

#### **Neni 30**

##### **Mbajtja e zgjedhjeve**

1. Zgjedhjet mbahen ditën e caktuar nga Këshilli Drejtues sipas kësaj rregulloreje.
2. Qendrat e vendvotimeve në të gjitha fakultetet hapen në orën 07:00 dhe mbyllen në orën 19:00. Përrjashtimisht nga kjo nëse në kohën e mbylljes së vendvotimeve ka radhë të votuesve, atëherë koha e mbylljes së vendvotimit shtyhet deri në votimin e studentit të fundit. Kjo kohë e votimit vlen edhe për sistemin online të votimit, në rastet kur vendoset që zgjedhjet studentore të mbahen online.
3. Numrin e vendvotimeve nëpër fakultete e cakton KQZ UP.

4. Në rast të mbajtjes së zgjedhjeve online, një procedurë e tillë bëhet përmes sistemit të votimit online të zhvilluar nga UP.

### **Neni 31**

#### **Qasja në vendvotim**

1. KZF obligohet që të sigurojë vendvotime të përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve në secilën ndërtesë të fakultetit përkatës. Pajisjet e nevojshme, siç janë kutitë e votimit, kabinat e votimit dhe materialet tjera të nevojshme për votim duhet të sigurohen nga KQZ UP.
2. Gjatë procesit të zgjedhjeve, përveç anëtarëve të KQZ UP-së dhe KZF-së, në vendvotime mund të kenë qasje edhe personat si në vijim:
  - 2.1. Vëzhguesit zyrtar të caktuar për zgjedhje;
  - 2.2. Votuesit;
  - 2.3. Personeli tjetër i caktuar zyrtar, përgjegjës për funksionim të rregullt të zgjedhjeve, i cili duhet të certifikohet nga KQZ UP, më së largu pesë (5) ditë para ditës së votimit.
3. Pas votimit, votuesi duhet të largohet nga vendvotimi pa vonesë.
4. Nëse paraqitet e nevojshme për arsye të funksionimit të rregullt të procedurës zgjedhore, kryesuesi i KQZ UP-së ose KZF-së ka të drejtë ta kufizojë qasjen e votuesve në vendvotim një nga një sipas radhës.
5. Në hyrje të vendvotimeve nuk lejohet prezenca e personave të paautorizuar, përveç atyre të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
6. Në rast të mbajtjes së zgjedhjeve online përmes votimit elektronik, paragrafët e mësipërm të këtij neni nuk aplikohen. Votimi elektronik menaxhohet dhe mbikëqyret nga KQZ UP.
7. Secila organizatë studentore e cila certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhje mund të ketë një (1) vëzhgues në vendvotim, në rast të mbajtjes së zgjedhjeve në mënyrë fizike. Në rast të mbajtjes së zgjedhjeve online organizatat studentore mund të kenë një (1) vëzhgues në KQZ UP, për monitorim dhe vëzhgim të votimit elektronik.

### **Neni 32**

#### **Mbrojtja e fshehtësisë së votës në vendvotim**

1. Secili vend votim duhet të ketë së paku një kabinë votimi.
2. Kabina e votimit duhet të vendoset në atë pozicion në mënyrë që votuesi të mos jetë i vëzhguar nga persona të tjerë që janë të pranishëm në vendvotim gjatë procedurës së votimit.
3. Gjatë kryerjes së procesit të votimit ndalohet përdorimi i telefonit dhe fotografimi i votës. Nuk lejohet asnjë veprim tjetër që cënon fshehtësinë e votës. Në rast të çfarëdo keqpërdorimi të të drejtave të votimit zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

4. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, fshehtësia e votës do të sigurohet përmes sistemit elektronik të votimit që dizajnohet dhe mirëmbahet nga UP.

### **Neni 33**

#### **Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor**

1. Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor përgatitet nga KQZ UP dhe shpërndahet në fakultetet përkatëse, nëpërmjet KZF-së.
2. Fletëvotimet për për Parlament të Studentëve dhe për këshilla të studentëve dhe, duhet të dallohen përmes ngjyrës.
3. Fletëvotimet duhet të palosen së paku njëherë, para se të hedhen në kutinë e votimit.
4. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, fletëvotimi dizajnohet në sistemin elektronik të votimit të UP-së. Për dukjen e fletëvotimit vendosë KQZ UP.

### **Neni 34**

#### **Respektimi i procedurave zgjedhore**

1. KQZ UP-ja, respektivisht KZF-ja, është përgjegjës për respektimin e procedurave zgjedhore në pajtim me këtë rregullore.
2. Çdo parregullësi në lidhje me procedurat zgjedhore, raportohet sipas kësaj rregulloreje.
3. Paragrafët e mësipërm të këtij neni aplikohen edhe me rastin e votimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve online.

### **Neni 35**

#### **Mënyra e votimit fizike dhe online**

1. Votimi duhet të bëhet personalisht.
2. Personat me nevoja të veçanta të cilët nuk mund të votojnë pa ndihmën e personit përcjellës, kanë të drejtë të zgjedhin një person i cili do t'i ndihmojë gjatë votimit.
3. Në rast se paraqitet ndonjë problem gjatë votimit, KQZ-UP do t'i marrë masat, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe këtë rregullore.
4. Sipas programit elektronik studentët votojnë sipas sistemit *double security*, ku për të votuar shfrytëzojnë llogarinë e tyre në SEMS, si dhe email adresën zyrtare në të cilën pranojnë linkun (kodin, i cili do të mbetet aktiv 10 minuta) përmes të cilit do të ushtrojnë të drejtën e votimit.

### **Neni 36**

#### **Verifikimi i votuesve**

1. Secili votues është i obliguar ta dëshmojë identitetin e tij / saj para KZF-së përmes paraqitjes së ID-kartelës së studentit ose indeksit, sipas listës së votuesve të pranuar nga KQZ-UP.

2. Vlerësimi i pranueshmërisë duhet të bëhet në bazë të listës zgjedhore për personat që kanë të drejtë votimi.
3. Verifikimi i votuesve me rastin e votimit elektronik bëhet nga vetë sistemi elektronik i votimit.

### **Neni 37**

#### **E drejta e votës dhe gabimet në votim**

1. Secili student me të drejtë vote, ka të drejtë të votoj për:
  - 1.1. Parlamentin e Studentëve të Universitetit;
  - 1.2. Këshillin e Studentëve në fakultetin ku ai/ajo është futur në listën e studentëve me të drejtë vote.
2. Në rast se ndodh ndonjë gabim nga votuesi gjatë plotësimit të fletëvotimit, KZF obligohet t'i ofrojë edhe një fletëvotim me kërkesën e votuesit. Fletëvotimi paraprak duhet të anulohet nga KZF në prani të votuesit dhe në mënyrë transparente.
3. Dorëzimi i fletëvotimit shtesë duhet të regjistrohet në protokollet e votimit, duke përpiluar shënim zyrtar.
4. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online çështjet e përcaktuara në paragrafët 1-3 të këtij neni përcaktohen në sistemin elektronik të votimit, që dizajnohet dhe mirëmbahet nga UP.

### **Neni 38**

#### **Regjistrimi i votuesve me rastin e votimit**

1. Studenti i cili ka votuar, duhet të regjistrohet në regjistrin e votimit nga një anëtar i KZF-së. Për regjistrim përdoret Formulari nr. 4 i kësaj rregulloreje.
2. Emri duhet të regjistrohet me numrin rendor origjinal të listës së votuesve me të drejtë vote.
3. Anëtari tjetër i KZF-së duhet ta evidentojë emrin e votuesit në listën e votuesve me të drejtë vote, sipas përmbajtjes së regjistrit.
4. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, regjistrimi i votuesve me rastin e votimit bëhet nga vetë sistemi elektronik i votimit.

### **Neni 39**

#### **Mënyra e regjistrimit të votuesve**

1. Studenti votuesi regjistrohet/evidentohet me vulë në anën e prapme të brendshme të indeksit të tij nga një anëtar i KZF-së, ndërsa në rastin e studentëve me ID-kartelë, regjistrimi bëhet përmes markerit special në pjesën e prapme të kartelës.
2. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, kjo dispozitë nuk aplikohet.

#### **Neni 40**

##### **Qartësimi i identitetit të votuesit**

1. Në rast të dyshimit të identitetit të studentit votues, KZF-ja ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë.
2. Nëse identiteti nuk mund të qartësohet, studenti nuk lejohet të votojë.
3. Pasi të dorëzohet fletëvotimi, asnjë dyshim tjetër sa i përket identitetit të votuesit nuk merret parasysh.
4. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, kjo dispozitë nuk aplikohet..

#### **Neni 41**

##### **Përmbajtja dhe formati i fletëvotimit**

1. Përmbajtja e fletëvotimeve përcaktohet nga KQZ-UP-ja, sipas kësaj rregulloreje.
2. Për fletëvotim përdoret formulari i fletëvotimit sipas Formularit nr. 5 të kësaj rregulloreje.
3. Renditja e organizatave studentore në fletëvotim përcaktohet me hedhje të shortit e cila realizohet nga KQZ UP-ja.
4. Përgatitja e fletëvotimeve duhet të realizohet nga KQZ-UP-ja sipas dinamikës së përcaktuar me këtë rregullore.
5. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, kjo dispozitë nuk aplikohet..

#### **Neni 42**

##### **Vlefshmëria e fletëvotimit**

1. Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm, nëse aty ka evidencë të pa diskutueshme për organizatën studentore të cilën votuesi e ka zgjedhur. Ky është rasti kur votuesi shënon në të majtë të emrit të organizatës së pranueshme me "iks" (x) apo me "tik" (✓), në mënyrë që qëllimi i votuesit për të zgjedhur organizatën përkatëse të tregohet me qartësi.
2. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online nuk aplikohet kjo dispozitë, për shkak se ky veprim mundësohet nga ana e sistemit elektronik i votimit.

#### **Neni 43**

##### **Pavlefshmëria e fletëvotimit**

1. Fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm, nëse:
  - 1.1. Grisët një pjesë në atë mënyrë që nuk do të ketë mundësi të qartësohet se cila organizatë studentore është votuar;
  - 1.2. Asnjë organizatë studentore nuk është shenjuar;
  - 1.3. Dy apo më shumë organizata studentore janë shenjuar;
  - 1.4. Shenjat në fletëvotime janë bërë në atë mënyrë që nuk mund të përcaktohet se cila organizatë studentore është votuar.

2. Fjalët, komentet apo shenjat tjera të cilat shënohen në fletëvotim e bëjnë fletëvotimin të pavlefshëm.
3. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online nuk aplikohet kjo dispozitë, për shkak se ky veprim mundësohet nga ana e sistemit elektronik i votimit..

#### **Neni 44**

##### **Numërimi i votave dhe dorëzimi i rezultateve**

1. Pasi të përfundojë orari i votimit, kryesuesi i KZF-së, konstaton përfundimin e votimeve. Vendvotimi duhet të mbyllet nga anëtarët e KZF-së në praninë e vëzhguesve dhe monitoruesve të certifikuar.
2. KZF-ja, i zbrazë kutitë me fletëvotime dhe:
  - 2.1. Numëron fletëvotimet për secilin organ të votuar;
  - 2.2. Konstaton numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listat e votimeve;
  - 2.3. Konstaton mospërputhjen eventuale të numrave sipas nën paragrafit 2.1 dhe 2.2 të këtij paragrafi.
3. KZF-ja, shpalos fletëvotimet, i rregullon sipas organit të votuar, kontrollon vlefshmërinë, identifikon fletëvotimet e pavlefshme sipas numrit të radhës dhe e konstaton:
  - 3.1. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura në kuti të votimit;
  - 3.2. Numrin e përgjithshëm të votave të pavlefshme;
  - 3.3. Numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme për secilën organizatë studentore.
4. Rezultatet sipas paragrafit 3 të këtij neni, menjëherë pas numërimit të votave i dorëzohen kryesuesit të KQZ UP-së në kopje të fortë fizike dhe elektronike.
5. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, kjo dispozitë nuk aplikohet.

#### **Neni 45**

##### **Raporti i KZF për rezultatet e zgjedhjeve**

1. Brenda njëzet e katër (24) orëve pas mbylljes së vendvotimit, KZF-ja duhet të dorëzojë në KQZ UP raport me shkrim për rezultatet e zgjedhjeve. Për raportim duhet të plotësohet Formulari i Protokollit të Procedurës së Zgjedhjeve sipas Formularit nr. 6 të kësaj rregulloreje.
2. Raporti duhet t'i përmbajë të dhënat si në vijim:
  - 2.1. Emrin e vendvotimit dhe datën e votimit;
  - 2.2. Emrat e anëtarëve të KZF-së;
  - 2.3. Emrat e vëzhguesve dhe monitoruesve;
  - 2.4. Numrin e saktë të fletëvotimeve të dorëzuara për secilin organ të votuar;
  - 2.5. Kohën e fillimit dhe e mbarimit të votimit;
  - 2.6. Vendimet e KZF-së për moslejimin eventuale të ndonjë votuesi për votim;
  - 2.7. Vendimet tjera të KZF-së gjatë periudhës së zgjedhjeve (p.sh. pengimet gjatë periudhës së zgjedhjeve, votimet përmes përcjelljes mbështetëse të studentit me nevoja të veçanta etj).



3. Raportit të KZF-së përkitazi me zgjedhjet, i bashkëngjiten:
  - 3.1. Lista e votuesve me të drejtë vote;
  - 3.2. Regjistri i votimit;
  - 3.3. Votat e pavlefshme, të ndara, paketuara dhe të shënuara për secilin organ që është në zgjedhje;
  - 3.4. Votat e vlefshme, të ndara, paketuara dhe të shënuara për secilin organ që është në zgjedhje;
  - 3.5. Fletëvotimet e pashfrytëzuara.
4. Raporti duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të KZF-së, vëzhguesve dhe monitoruesve. Në rast të refuzimit të nënshkrimit, arsytet duhet të evidentohen në raport.
5. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, kjo dispozitë nuk aplikohet.. Raporti përfundimtar për rezultatet e zgjedhjeve gjenerohet nga sistemi elektronik i votimit.

#### **Neni 46**

#### **Pengimi i procesit të votimit**

1. Në rast të rrethanave të veçanta apo incidenteve në vendvotim, KZF-ja mund të ndërpres procesin e votimit dhe të vazhdojë votimin në një ditë tjetër.
2. Në rastet kur personat e paautorizuar pa përjashtim, në forma të ndryshme ndërhyjnë në proces të zgjedhjeve, KZF respektivisht KQZ UP, do të ndërmarrin veprimet e duhura ligjore për raportim të rastit në organet vendimmarrëse të UP-së, përfshirë edhe iniciimin e procedurës penale pranë organeve kompetente shtetërore.
3. Secila shtyrje e zgjedhjeve duhet të shpallet në publik pa vonesë nga kryesuesi i KZF-së.
4. Nëse procesi i votimit ka filluar dhe në zhvillim e sipër shfaqen pengesa, të gjitha fletëvotimet dhe kutitë e votimit duhet të mbyllen nga kryesuesi i KZF-së derisa procedura zgjedhore të vazhdohet.
5. Gjatë zhvillimit të procesit të votimit personat e paautorizuar sipas kësaj rregullore nuk kanë të drejtë të afrohen në sallat ku janë duke u mbajtur votimet, në të kundërtën KZF merr masat e caktuara sipas kësaj rregullore.
6. Përkitazi me zbatimin e këtij neni, kryesuesi i KZF-së informon policinë dhe KQZ UP-në.
7. Në rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online, pengimi i procesit të votimit nënkupton ndërhyrjet e paautorizuara në sistemin e votimit elektronik që mirëmbahet nga UP. Në rast se këto ndërhyrje janë evidente, KQZ UP mund të ndërpres votimin për momentin, si dhe të ndërmarr të gjitha masat, përfshirë edhe iniciimin e rastit në organet kompetente.

#### **Neni 47**

#### **Shpërndarja e mandateve të fituara**

1. Shpërndarja e mandateve bëhet nga KQZ UP-ja në pajtim me këtë rregullore.

2. Për shpërndarjen e mandateve, duhet të përdoret formulari sipas Formularit nr. 7 të kësaj rregullore.
3. Shpërndarja e mandateve në rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online bëhet pas nxjerrjes së raportit të gjeneruar nga sistemi i votimit elektronik.

#### **Neni 48**

##### **Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve**

1. Rezultati preliminar i zgjedhjeve publikohet nga KQZ UP, më së largu njëzet e katër (24) orë pas përfundimit të zgjedhjeve.
2. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve publikohet nga KQZ UP, më së largu pesë (5) ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.
3. Shpallja duhet të përmbajë:
  - 3.1. Rezultatin e zgjedhjeve në numra, të renditur sipas organizatës studentore;
  - 3.2. Listën e kandidatëve për secilin organ;
  - 3.3. Numrin e përgjithshëm të mandateve për secilën organizatë studentore të votuar në kuadër të Parlamentit dhe këshillave të studentëve.
4. Shpallja e rezultateve me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve online bëhet përmes raportit elektronik të cilin e gjeneron sistemi i votimit elektronik që mirëmbahet nga UP.

#### **Neni 49**

##### **Konfirmimi i mandatave**

1. Të gjithë studentët që kanë fituar mandate, duhet të informohen nga KQZ UP, përmes personit të autorizuar të organizatës studentore, dy (2) ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.
2. Për letrën informuese mund të përdoret formulari për njoftimin e mandatarëve sipas Formularit nr. 8 të kësaj rregulloreje.
3. Mandati konsiderohet i pranuar, nëse mandatarin nuk e kundërshton zgjedhjen e tij/saj brenda dy (2) ditëve pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve.
4. Në rast të kundërshtimit apo dorëheqjes nga mandatarin, mandati duhet t'i caktohet kandidatit vijues sipas renditjes së listës së kandidatëve.

#### **Neni 50**

##### **Ankimimi ndaj procesit zgjedhor**

1. Kundërshtimet ndaj shkeljes së procedurave dhe rezultateve të zgjedhjeve të studentëve duhet t'i parashtrihen KQZ UP-së brenda njëzet e katër (24) orëve pasi të jenë shpallur rezultatet preliminare të zgjedhjeve.
2. Kundërshtimet eventuale të studentëve dhe organizatave studentore ndaj rezultateve zgjedhore, shqyrtohen dhe vendosen nga KQZ-UP-ja brenda njëzet e katër (24) orëve pas pranimit të tyre.

3. Ankesat ndaj vendimeve të KQZ-UP-së, lidhur me kundërshtimet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, shqyrtohen dhe vendosen nga Këshilli Drejtues i UP-së si shkallë e dytë.
4. Çdo ndryshim në rezultatin e zgjedhjeve për arsye të pranimit të ankesave duhet të shpallet publikisht nga KQZ UP. Vendimi i Këshillit Drejtues është përfundimtar.
5. Në rastet kur KQZ UP, konstaton shkelje dhe mosrespektim të dispozitave të kësaj rregulloreje, mund të rekomandojë anulim të rezultateve dhe përsëritje të procesit zgjedhor. Vendimi përfundimtar merret nga Këshilli Drejtues.

#### **Neni 51**

#### **Përsëritja e procesit zgjedhor**

1. Nëse Këshilli Drejtues konstaton se shkeljet e procedurave të zgjedhjeve kanë qenë të atyre përmasave të cilat esencialisht kanë ndikuar në rezultatin zgjedhor, procesi zgjedhor do të përsëritet sipas procedurës së njëjtë vetëm në fakultetin përkatës. Ky proces i përsëritjes së zgjedhjeve duhet të mbahet brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së vendimit përfundimtar nga Këshilli Drejtues.
2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet vetëm në rast se mbështet në prova të forta dhe të pakontestueshme, të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

### **Kapitulli III**

## **KONSTITUIMI I PARLAMENTIT, KËSHILLAVE TË STUDENTËVE DHE PUNA E TYRE**

#### **Neni 52**

#### **Parimet e konstituimit të Parlamentit dhe këshillave të studentëve**

1. Parlamenti i Studentëve dhe këshillat e studentëve duhet të konstituohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore. Parlamenti i Studentëve dhe këshillat e studentëve konsiderohen se janë konstituuar me zgjedhjen e kryetarit të Parlamentit, respektivisht të Këshillit të Studenteve.
2. Të drejtën për të zgjedhur kryetarin e parlamentit apo të këshillit të studentëve e kanë secila organizatë studentore që ka fituar vende në Parlamentin apo në Këshillin e Studentëve dhe të cilët kanë shumicën e nevojshme për zgjedhjen e kryetarit të Parlamentit dhe Këshillit të Studentëve.
3. Mbledhjen konstituive të Parlamentit të Studentëve e udhëheq KQZ UP, kurse mbledhjen konstituive të Këshillit të Studentëve e udhëheq KZF. Mbledhja konstituive, me qëllim të zgjedhjes së kryetarit të Parlamentit të Studentëve thirret nga KQZ UP, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas certifikimit të zgjedhjeve studentore. Mbledhja konstituive e Parlamentit thirret nga KQZ UP vetëm pasi organizatat studentore të deponojnë marrëveshjen e nënshkruar për koalicion me të cilën dëshmojnë që kanë krijuar shumicën e nevojshme për të zgjedhur kryetarin e Parlamentit të Studentëve. Marrëveshja e nënshkruar nga organizatat studentore deponohet në KQZ UP dhe në Këshillin Drejtues të UP-së dhe në marrëveshje duhet të jenë të nënshkruar anëtarët e Parlamentit të Studentëve që kanë fituar mandate dhe që janë pjesë e marrëveshjes për të votuar kryetarin e

Parlamentit të Studentëve. Në çdo rast, marrëveshja duhet të deponohet në KQZ UP dhe në Këshillin Drejtues, brenda afatit prej trembëdhjetë (13) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve përfundimtare.

4. Mbledhja konstituive, me qëllim të zgjedhjes së kryetarit të këshillit të studentëve thirret nga KZSF, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas certifikimit të zgjedhjeve studentore. Mbledhja konstituive e këshillit të studentëve thirret nga KZSF vetëm pasi organizatat studentore të deponojnë marrëveshjen e nënshkruar për koalicion me të cilën dëshmojnë që kanë krijuar shumicën e nevojshme për të zgjedhur kryetarin e Këshillit të Studentëve. Marrëveshja e nënshkruar nga organizatat studentore deponohet në KQZ UP dhe në Këshillin Drejtues të UP-së dhe në marrëveshje duhet të jenë të nënshkruar anëtarët e Këshillit të Studentëve që kanë fituar mandate dhe që janë pjesë e marrëveshjes për të votuar kryetarin e Këshillit të Studentëve. Në çdo rast marrëveshja duhet të deponohet në KQZ-UP dhe në Këshillin Drejtues, brenda afatit prej trembëdhjetë (13) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve përfundimtare.
5. Marrëveshja e nënshkruar nga organizatat studentore dhe anëtarët që kanë fituar mandate, për parlament dhe këshilla të studentëve, sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ka fuqi obliguese për të gjitha organizmat studentore që e kanë nënshkruar dhe e njëjta nuk mund të ndryshohet, përdërisa nuk ka një marrëveshje tjetër në mes të organizatave studentore, respektivisht një shumicë të re të krijuar përmes një marrëveshje të re, për Parlament apo këshilla të studentëve. Konstituimi i PS dhe KS duhet të bëhet në bazë të marrëveshjes së nënshkruar dhe në asnjë rast ndryshimi i marrëveshjes nuk mund të bëhet para seancës së parë konstituive të PS apo KS.
6. Në marrëveshjen për Parlamentin e Studentëve dhe këshillat e studentëve, e cila deponohet në KQZ UP dhe Këshill Drejtues duhet të përcaktohen detajet e përfaqësimit të studentëve, udhëheqjes së Parlamentin e Studentëve dhe këshillave të studentëve, si dhe përfaqësimi i studentëve në Senat dhe organet e tjera.
7. Nëse organizatat studentore nuk arrijnë të krijojnë shumicën dhe të deponojnë marrëveshjen në KQZ UP dhe Këshillin Drejtues, sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni, në afat prej trembëdhjetë (13) ditësh, Këshilli Drejtues do të vlerësojë situatën dhe do të marrë masa konkrete ndaj organizatave, duke mos përjashtuar edhe shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për PS dhe KS.
8. Të drejtën e propozimit të kryetarit, nënkryetarit, sekretarit të Parlamentit të Studentëve apo të Këshillit të Studentëve në mbledhje konstituive e kanë organizatat që kanë deponuar marrëveshjen, sipas paragrafit 4 dhe 5, ashtu siç përcaktohet në marrëveshje. Në marrëveshje nuk mund të parashihen pozita të cilat nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore.
9. Ftesa për mbledhjen konstituive të Parlamentit dhe këshillit të studentëve duhet të bëhet për secilin përfaqësues që ka fituar mandat në mënyrë individuale nga kryesuesi i KQZ UP dhe KZSF, duke shfrytëzuar Formularin nr. 8 të kësaj rregulloreje.
10. Refuzimi (mospranimi) i mandateve duhet të bëhet ashtu siç parashihet në nenin 49, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje. Mandatari zëvendësues duhet të zgjedhet nga lista zyrtare e kandidatëve të organizatës përkatëse dhe zëvendësimi me kandidatin e radhës në listë duhet zyrtarisht t'i paraqitet KQZ UP përkatëse vetëm nga përfaqësuesi i autorizuar nga organizata studentore përkatëse, brenda afatit prej dy (2) ditëve të punës.

11. Procedura e zëvendësimit për mandatar nuk duhet të ketë ndonjë efekt të shtyrjes së konstituimit, por duhet t'i përmbahet procedurave dhe orareve për konstituim dhe funksionim të mëtutjeshëm të organeve përfaqësuese të studentëve.
12. Asnjë përfaqësues i cili ka fituar mandatin, sipas rezultateve të certifikuara nga KQZ UP, nuk guxon të mungojë në mbledhjen konstituive të Parlamentit apo Këshillit të Studentëve. Mungesa në mbledhjen konstituive nënkupton heqje dorë nga mandati, përveç në rastet e sëmundjes ose vdekjes së anëtarit/es të ngushtë të familjes e cila duhet të dëshmohet me dokumente përkatëse. KQZ UP/KZF, do ta zëvendësojë mandatarin i cili pa arsye ka munguar në mbledhje konstituive me studentët pasues në listën e kandidatëve të organizatës studentore përkatëse.
13. Në rast të refuzimit të njëpasnjëshëm të mandateve nga studentët pasues në listën e kandidatëve të organizatës studentore dhe në mungesë të kandidatëve të tjerë në listë, KQZ UP konstaton se organizata përkatëse e humb të drejtën e përfaqësimit në organin respektiv.
14. Në rast se në procedurë të konstituimit por edhe më pas, një anëtar i PS/KS humb mandatin dhe në listën e organizatës studentore nuk ka student/e tjetër për të pranuar mandatin, vendi i mandatarit mbetet vakant dhe numri i tërësishëm i anëtarëve të PS/KS në kuorum llogaritet duke minusuar mandatin e humbur.
15. Gjatë ushtrimit të mandatit, në rast se mandatarët e PS dhe KS e konsiderojnë të nevojshme mund të ndryshojnë marrëveshjen për qeverisje, duke lidhur një marrëveshje të re, në procedura të njëjta, sikur në paragrafët e mësipërme të këtij neni. Marrëveshja e re i dorëzohet si njoftim Këshillit Drejtues, zyrtarit përkatës në KQZ UP, si dhe KZ të Fakultetit përkatës. E njëjta më pas mund të votohet nga anëtarët e PS dhe KS dhe qeverisja e mëtutjeshme e PS dhe KS mund të vazhdojë përmes marrëveshjes së re.
16. Mandati i anëtarëve të PS/KS është i lirë dhe i njëjti mund të hiqet, vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 10 të kësaj rregulloreje. Në rastin e plotësimit të kushteve për përfundimin e mandatit, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje, PS/KS është i obliguar që pa vonesa të njoftojë KQZ UP-në për anëtarët e PS dhe KZF-në për anëtarët e KS, për zëvendësimin e mandatit. Në rast të mosnjoftimit do të merren masa disiplinore ndaj kryetarit të PS/KS.
17. Ankesat lidhur me përfundimin e mandatit mund të dorëzohen pranë Këshillit Drejtues nga secili anëtar i organit përkatës. Procedura e zëvendësimit të mandatarit të ri duhet të bëhet sipas renditjes nga lista e kandidatëve të certifikuar. Në rast se organizata përkatëse nuk ka anëtarë të tjerë në listë të pritjes vendi mbetet vakant.
18. Parlamenti i Studentëve përmes konsultave, në detyra funksionale ndihmohet nga Këshilli Drejtues dhe sekretari i përgjithshëm i UP-së.

### **Neni 53**

#### **Mandati dhe verifikimi i mandatit**

1. Mandati i anëtarëve të PS/KS fillon me 1 tetor të vitit kur janë mbajtur zgjedhjet studentore.

2. Mandati i anëtarëve të PS/KS zgjatë për një periudhë prej dy vitesh.
3. Në mbledhjen konstituive të PS/KS, mandati i secilit anëtarë duhet të verifikohet nga KQZ UP-ja, përkatësisht KZF-ja, duke u bazuar në listën zyrtare të mandatarëve e cila është përgatitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
4. Verifikimi i mandateve duhet të regjistrohet në procesverbal të mbledhjes konstituive. Mandatet e fituara të cilat nuk mund të verifikohen duke u bazuar në dokumentacionin përkatës të KQZ UP-së, të njëjtët duhet të largohen nga mbledhja. KQZ UP kërkon nga organizata përkatëse studentore të bëjë zëvendësimin e mandatarëve ashtu si parashihet në këtë Rregullore.
5. Pavarësisht dispozitave të mësipërme, në rastin e mbajtjes së zgjedhjeve studentore, kur organet e UP-së, ku janë të përfaqësuar studentët kanë funksion konstituive dhe zgjedhor, në mbledhjet e këtyre organeve marrin pjesë studentët të cilët kanë fituar mandat në zgjedhjet e reja studentore të mbajtura dhe të certifikuara.
6. Ndërlidhur me paragrafin 5 të këtij neni, me rastin e konstituimit, përbërjet e reja të Parlamentit të Studentëve, respektivisht këshillave të studentëve, respektivisht të deleguarit e tyre në organet e UP-së, ushtrojnë mandat, gjegjësisht funksione zgjedhore, ndërsa mandatin funksional e nisin më 1 tetor, me përjashtim të rastit të mbajtjeve të zgjedhjeve të parakohshme.

#### **Neni 54 Deklarata etike**

Me fillimin e mandatit të tyre, secili anëtar i PS dhe KS duhet të nënshkruaj deklaratën etike si më poshtë: *"Deklaroj se do t'i kryej detyrat e mia me nderë dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me integritet dhe përgjegjësi dhe do të kontribuoj në përmbushjen e detyrave të PS dhe KS, do të ushtroj mandatin tim me vigjilencë dhe përkushtim në interes të Universitetit dhe studentëve, si dhe do t'i përmbahem rregullave të Statutit të Universitetit të Prishtinës"*.

#### **Neni 55 Zgjedhja kryetarit dhe sekretarit të Parlamentit të Studentëve**

1. Kryetari i PS zgjedhet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Parlamentit, bazuar në marrëveshjen e cila deponohet në KQZ UP dhe Këshillin Drejtues, sipas nenit 52 të kësaj rregulloreje.
2. PS mund të zgjedh deri në dy (2) nënkryetarë, me shumicë të thjeshtë dhe duke u bazuar në marrëveshjen e deponuar sipas nenit 52. Në rast të lidhjes së marrëveshjes së re, në rastin e nënkryetarëve vlejné të njëjtat procedura sikur për kryetarin e PS.
3. Në rast se organizatat studentore nuk arrijné të zgjedhin kryetarin e Parlamentit, sipas marrëveshjes së deponuar, në bazë të nenit 52, Këshilli Drejtues merr masa ndaj organizatave përkatëse të cilat nuk e kanë realizuar marrëveshjen e deponuar në KQZ-UP dhe Këshillin Drejtues.
4. Pas zgjedhjes së Kryetarit, zgjedhet sekretari me shumicën e thjeshtë të votave përmes votimit të hapur, sipas marrëveshjes që përcaktohet në nenin 52 të kësaj rregulloreje.

5. Pas zgjedhjes së kryetarit dhe sekretarit të PS, kryetari i KQZ UP-së ia dorëzon udhëheqjen e mbledhjes kryetarit të PS-së, ndërsa procesverbali i dorëzohet sekretarit të PS-së dhe Parlamenti konsiderohet i konstituuar.
6. Zgjedhja e kryetarit dhe sekretarit në mbledhjen konstituive duhet të bëhet sipas marrëveshjes, bazuar në nenin 52. Në rast se në marrëveshje përcaktohet sistemi i kryetarëve me rotacion, kryetarët e tjerë që do ta drejtojnë PS-në sipas rotacionit nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër procedurë të zgjedhjes individuale, mirëpo periudha e mandatit brenda rotacionit duhet të bëhet sipas marrëveshjes që përcaktohet në nenin 52. E njëjta vlen edhe për sekretarin e PS. Në të gjitha rastet kur mandati i kryetarit të Parlamentit të Studentëve është me rotacion, sekretari i KQZ UP duhet të njoftohet për ndryshimin e kryetarit, brenda periudhës së rotacionit, sipas marrëveshjes së përcaktuar në nenin 52. Në rast të përfundimit të periudhës së rotacionit, kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i Parlamentit të Studentëve nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim në ushtrimin e funksionit të tyre.
7. Në rast të lidhjes së marrëveshjes së re, gjatë ushtrimit të mandatit, kryetari dhe sekretari i PS duhet të zgejdhen sipas procedurës që përcaktohet në këtë nen.

#### **Neni 56**

#### **Shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Parlamentit të Studentëve**

1. Kryetari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute (50%+1), përmes një votimi në bazë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të PS.
2. Seancën e jashtëzakonshme për shkarkimin e kryetarit mund ta thërrasin kryetari ose 1/3 e anëtarëve të PS. Mbledhjen e thirrur e kryeson njëri prej nënkryetarëve, sekretari ose anëtari më i vjetër në moshë i Parlamentit të Studentëve. Kryetari mund ta thërras mbledhjen për shkarkimin e tij/saj vetëm një (1) herë.
3. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit, nënkryetari i parë e merr kryesimin e përkohshëm dhe brenda pesë (5) ditëve të punës e thërret takimin për zgjedhjen e kryetarit të ri.
4. Sekretari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave të anëtarëve të PS-së, të pranishëm dhe që votojnë.
5. Seancën e jashtëzakonshme për shkarkimin e sekretarit mund ta thërrasin kryetari ose 1/3 e anëtarëve të PS.
6. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të sekretarit, kryetari cakton njërin nga dy nënkryetarët përkohësisht në marrjen e obligimeve të sekretarit dhe duhet të caktojë një pikë në rendin e ditës të po atij takimi për zgjedhjen e sekretarit të ri.
7. Në rast të dështimit për shkarkimin e kryetarit apo sekretarit të PS-së, një mbledhje tjetër me të njëjtën pikë të rendit të ditës nuk mund të thirret në afatin më të afërt se tridhjetë (30) ditë.
8. Pas shkarkimit të kryetarit apo sekretarit të Parlamentit të Studentëve, organizatat studentore mund të zgjedhin kryetarin e ri të PS, brenda marrëveshjes aktuale, sipas nenit 52. Në rast të lidhjes së marrëveshjes së re, para ose pas shkarkimit të kryetarit të PS, nuk

aplikohen dispozitat e këtij neni për shkarkimin e kryetarit të PS, por vetëm bëhet zgjedhja e kryetarit të ri, në bazë të marrëveshjes së re të lidhur në mes të organizatave studentore, ashtu siç përcaktohet në këtë rregullore.

### **Neni 57**

#### **Zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të Studentëve**

1. Kryetari i KS zgjedhet me vota të shumicës absolute nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KS në fakultetin përkatës. Propozimet për kandidatë bëhen në mbledhjen konstituive të udhëhequr nga kryetari i KZF-së dhe votohen ashtu siç parashihet në dispozitat e kësaj rregulloreje, duke u bazuar në marrëveshjen e organizatave studentore e cila deponohet në KQZ-UP dhe në Këshill Drejtues, sipas nenit 52 të kësaj rregulloreje.
2. Kryetari i KS shkarkohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Studentëve.
3. Seancën e jashtëzakonshme për shkarkimin e kryetarit mund ta thërrasin Kryetari ose 1/3 e anëtarëve të KS. Mbledhjen e thirrur e kryeson njëri prej nënkryetarëve, sekretari ose anëtari më i vjetër në moshë i këshillit të studentëve. Kryetari mund ta thërras mbledhjen për shkarkimin e tij/saj vetëm një (1) herë.
4. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit, nënkryetari i parë e merr kryesimin e përkohshëm dhe brenda pesë (5) ditëve të punës e thërret takimin për zgjedhjen e kryetarit të ri.
5. Sekretari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë të KS.
6. Seancën e jashtëzakonshme për shkaktimin e sekretarit mund ta thërrasin kryetari ose 1/3 e anëtarëve të KS.
7. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të sekretarit, kryetari cakton njërin nga dy nënkryetarët përkohësisht në marrjen e obligimeve të sekretarit deri në mbledhjen e parë të radhës ku edhe duhet të caktojë një pikë në rendin e ditës për zgjedhjen e sekretarit të ri.
8. Në rast të dështimit për shkarkimin e kryetarit apo sekretarit të KS, një mbledhje tjetër me të njëjtën pikë të rendit të ditës nuk mund të thirret në afatin më të afërt se tridhjetë (30) ditë.
9. Zgjedhja e kryetarit dhe sekretarit të KS në mbledhjen konstituive duhet të bëhet sipas marrëveshjes, bazuar në nenin 52. Në rast se në marrëveshje përcaktohet sistemi i kryetarëve me rotacion, kryetarët e tjerë që do ta drejtojnë KS sipas rotacionit nuk kanë nëvojë të kalojnë nëpër procedurë të zgjedhjes individuale, mirpo periudha e mandatit brenda rotacionit duhet të bëhet sipas marrëveshjes që përcaktohet në nenin 52. E njëjta vlen edhe për sekretarin e KS. Në të gjitha rastet kur mandati i kryetarit të KS është me rotacion, kryesuesi i KZF duhet të njoftohet për ndryshimin e kryetarit, brenda periudhës së rotacionit, sipas marrëveshjes të përcaktuar në nenin 52. Në rast të përfundimit të periudhës së rotacionit, kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i KS nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim në ushtrimin e funksionit të tyre.



10. Në rast të lidhjes së marrëveshjes së re, gjatë ushtrimit të mandatit kryetari dhe sekretari i KS duhet të zgjedhen sipas procedurës që përcaktohet në këtë nen.
11. Pas shkarkimit të kryetarit apo sekretarit të KS organizatat studentore mund të zgjedhin kryetarin e ri të KS, brenda marrëveshjes aktuale, sipas nenit 52. Në rast të lidhjes së marrëveshjes së re, para ose pas shkarkimit të kryetarit të KS, nuk aplikohen dispozitat e këtij neni për shkarkimin e kryetarit të KS por vetëm bëhet zgjedhja e kryetarit të ri, në bazë të marrëveshjes së re të lidhur në mes të organizatave studentore, ashtu siç përcaktohet në këtë rregullore.

### **Neni 58**

#### **Zgjedhja dhe shkarkimi i nënkryetarit të PS dhe nënkryetarit të KS**

1. PS/KS mund të zgjedhë deri në dy (2) nënkryetarë. Vendimi për numrin e nënkryetarëve merret me votim të hapur me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.
2. Kryetari dhe nënkryetarët duhet të jenë nga organizata të ndryshme studentore.
3. Secili nënkryetar duhet të zgjedhet në votime të ndara me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, bazuar në marrëveshjen e deponuar sipas nenit 52 të kësaj rregulloreje.
4. Në rast të mungesës së kryetarit, mbledhjen e kryeson nënkryetari i parë.
5. Nënkryetari mund të shkarkohet nga funksioni me shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm anëtarëve.
6. Në rast të dështimit për shkarkimin e nënkryetarit të PS, një mbledhje tjetër me të njëjtën pikë të rendit të ditës nuk mund të thirret në afatin më të afërt se tridhjetë (30) ditë.
7. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të nënkryetarit, kryetari thërret mbledhjen për zgjedhjen e nënkryetarit të ri në afat prej shtatë (7) ditësh, bazuar në marrëveshjen e deponuar, sipas nenit 52 të kësaj rregulloreje.
8. Në rastin e lidhjes së marrëveshjes së re, sipas nenit 52, për nënkryetarët e PS/KS vlejnë të njëjtar dispozita sikur në rastin e kryetarit të PS/KS, përfshirë edhe ldhjen e marrëveshjes së re.

### **Neni 59**

#### **Mbledhjet e PS dhe KS**

1. Kryetari i thërret dhe i kryeson mbledhjet.
2. Nëse kryetari nuk ka mundësi të kryesojë mbledhjen, atëherë mbledhja kryesohet nga nënkryetari i parë. Në rast se të gjithë nënkryetarët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, atëherë mbledhjen e kryeson sekretari.
3. Kryetari thërret takimet e PS/KS sipas nevojës. Gjatë periudhës së vitit akademik, duke mos llogaritur periudhën e pushimeve, mbledhjet e rregullta të PS/KS duhet të mbahen së paku njëherë në tre (3) muaj.

4. Mbledhjet e jashtëzakonshme të PS/KS mund të mbahen në çdo kohë sipas procedurave të parapara në këtë rregullore. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren në çdo kohë nga kryetari ose 1/3 e anëtarëve, sipas një arsyetimi bindës dhe përmbajtësor. Rendi i ditës duhet të kufizohet në një pikë. Gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme të PS/KS mund të caktohet mbledhja e radhës. Në këtë rast, anëtarët që mungojnë në mbledhje të PS/KS duhet të ftohen veçmas. Mbledhja e jashtëzakonshme duhet të mbahet në një afat, jo më larg se 24 orë, nga momenti i thirrjes.
5. Mbledhjet e jashtëzakonshme udhëhiqen nga kryetari, na rast të mungesës së tij nga nënkryetarët, apo në mungesë të tyre nga sekretari i PS/KS.
6. Në rast të shkarkimit apo dorëheqjes së kryetarit dhe të gjithë nënkryetarëve, atëherë Këshilli Drejtues autorizon sekretarin e përgjithshëm të zhvillojë procedurat për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve në pajtim me këtë rregullore. Për të zgjedhur kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarin, organizatat studentore duhet të deponojnë marrëveshjen, ashtu siç është përcaktuar në nenin 52 të kësaj rregulloreje.
7. Anëtarët e PS/KS duhet të ftohen nga sekretari i PS/KS së paku tri (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes, ftesa mund të bëhet me shkrim përmes e-mailit.
8. Mbledhjet e PS/KS duhet të jenë të hapura për publik, përveç në ato raste kur PS/KS vendos ndryshe me shumicë votash.
9. Sipas nevojës, në mbledhjet e PS mund të ftohen edhe kryetarët e këshillave të studentëve.
10. Kryetari i PS/KS nuk mund të veprojë dhe të proklamojë vendime në emër të PS/KS, pa marrë vendim apo pajtim të PS/KS.
11. Kryetari i PS/KS është njëri nga anëtarët e barabartë të PS/KS.
12. Mbledhjet e PS/KS mund të mbahen edhe online përmes platformave të pranueshme, Google Meet, Zoom etj.

## **Neni 60**

### **Pjesëmarrja në mbledhje dhe zëvendësimi**

1. Të gjithë anëtarët e PS / KS kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje të organit përkatës.
2. Delegimi i votës nuk është i lejueshëm. Anëtarët duhet të nënshkruajnë listën e pjesëmarrjes në secilën mbledhje të PS / KS, lista e pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e procesverbalit të mbledhjes e cila përgatitet dhe shpërndahet nga sekretari i organit përkatës.
3. Anëtari i PS/KS mund të mungojë në mbledhje vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe për këtë duhet të njoftohet me kohë kryetari.
4. Nëse anëtari i PS/KS është ftuar rregullisht në mbledhje dhe i njëjti mungon pa arsye për gjashtë (6) muaj gjatë gjithë mandatit, në mbledhjet e rregullta sipas ftesës, të njëjtit i pushon mandati.

5. Anëtarit të cilit i pushon mandati për arsyet e përcaktuara me këtë rregullore, duhet të zëvendësohet me anëtar të ri sipas radhës nga lista e kandidatëve të organizatës studentore përkatëse.

### **Neni 61 Konflikti i interesit**

1. Anëtari i PS/KS konsiderohet se është në konflikt interesi nëse mandati i tij është në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore.
2. Nëse PS/KS nuk vendos ndryshe, anëtari në konflikt interesi duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë kohës kur diskutohet dhe votohet për çështjet për të cilat konsiderohet se ka konflikt interesi.
3. Vendimi për përjashtimin e një anëtari për çështjen e caktuar për arsye të konfliktit të interesit, mund të ankimohet brenda dy ditëve përmes një ankese me shkrim e cila i adresohet Këshillit Drejtues të UP-së. Ankesa duhet të shqyrtohet në afat të arsyeshëm. Në rast të pranimit të kërkesës, çështja duhet të rivendoset në rend të ditës për mbledhjen vijuese të organit përkatës dhe të gjitha vendimet për të cilat është përjashtuar nga mbledhja anëtari i PS/KS, konsiderohen të pavlefshme.

### **Neni 62 Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës të PS/KS**

1. Kryetari e kryeson, e ndërprejë dhe mbyll mbledhjen.
2. Rendi i ditës përgatitet nga kryetari në bashkëpunim me nënkryetarët dhe sekretarin.
3. Kryetari është i obliguar të përfshijë në rend të ditës, kërkesat me shkrim të cilat janë dorëzuar me kohë.
4. Sekretari i PS/KS është i obliguar që përmes postës elektronike (e-mail) të gjithë anëtarëve të PS/KS t'ua përcjellë ftesën për pjesëmarrje në mbledhje, rendin e ditës dhe materialin përkatës për diskutim në mbledhje.
5. Mbledhjet e PS/KS duhet të kenë kuorumin prej 50%+1% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
6. Në fillim të mbledhjes, kryetari konfirmon anëtarët pjesëmarrës dhe ata që mungojnë dhe pasi sigurohet se ekziston kuorumi, propozon rendin e ditës, hap diskutimin për rendin e ditës, konfirmon miratimin e rendit të ditës dhe e vazhdon mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.
7. Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në miratimin e procesverbalit të mbledhjes paraprake.
8. Anëtarët e PS/KS kanë të drejtë të paraqesin vërejtje në procesverbal dhe të kërkojnë që të bëhen ndryshime, ose plotësime konform diskutimeve të realizuara në mbledhjen përkatëse. Për themelësinë e vërejtjeve në procesverbal vendoset me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

9. Anëtarët e PS/KS kanë të drejtë të propozojnë ndryshime apo plotësime të rendit ditës.
10. Materialet apo kërkesat e dorëzuara gjatë takimit mund të aprovohen me shumicën absolute të votave.
11. Procesverbalet dhe kopjet e vendimeve të PS/KS duhet të arkivohen në dosje të PS/KS.

### **Neni 63**

#### **Ecuria e mbledhjes së PS/KS**

1. Pas miratimit të rendit të ditës, vazhdohet me diskutime për çështjet e rendit të ditës.
2. Raporti dhe arsyetimi për secilën pikë të rendit të ditës prezantohet nga kryetari apo personi i caktuar nga kryetari, pastaj kryetari hap diskutimin.
3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të PS/KS mund të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin pikëpamjet dhe propozimet për çështjet për të cilat do të vendoset në mbledhje.
4. Kryetari ia jep fjalën diskutuesit sipas radhës, e konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, e konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerri masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, e konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerri veprime të tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes sipas kësaj rregulloreje.
5. Në mbledhje askush nuk mund të diskutojë pa iu dhënë fjala nga kryetari.
6. Për secilën pikë të rendit të ditës një anëtar mund të diskutojë deri dy herë, herën e parë deri në pesë (5) minuta dhe herën e dytë deri në dy (2) minuta.
7. Kryetari ka të drejtë të i'u përkujtojë anëtarëve që t'i përmbahen rendit të ditës.
8. Kryetari ka të drejtë të ndërpres mbledhjen më së shumti tridhjetë (30) minuta. Me pëlqimin e shumicës së anëtarëve të PS/KS, kjo periudhë kohore mund të zgjatet.
9. Kryetari mund të ndërpres mbledhjen nëse konsideron se mbledhja nuk mund të vazhdohet në mënyrë të rregullt.

### **Neni 64**

#### **Vendimmarrja, votimi dhe zgjedhja**

1. Vendimet e PS/PS janë të plotfuqishme vetëm nëse kuorumi vërtetohet në kohën e votimit.
2. Para se të votohet, kryetari e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
3. Pas formulimit të vendimit dhe rishikimit, sipas kërkesës dhe pikave në rend të ditës, PS/KS merr vendim ose nxjerr konkluzione.
4. PS/KS merr vendim me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm.

5. Nëse ka më shumë kërkesa, së pari votohet për ato që janë në materialet e propozuara dhe pastaj votohet për propozime tjera.
6. Votimi bëhet përmes aklamacionit (me ngritje dore) apo përmes votës së fshehtë. Mënyra e votimit vendoset gjatë takimit të PS/KS me shumicë të thjesht votash.
7. Votimi bëhet: "për"; "kundër dhe "abstenim".
8. Në rast të votave të barabarta, konsiderohet se votimi ka dështuar.
9. Vendimet e PS/KS mund të merren edhe përmes një procedure qarkulluese, të votimit përmes emailit.

#### **Neni 65**

##### **Mbajtja e rendit në mbledhje e PS/KS**

1. Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryetari i mbledhjes.
2. Për shkeljen e rendit në mbledhje, kryetari mund të shqiptojë vërejtje me gojë, ndërsa me shumicën e thjeshtë të votave PS/KS mund të ndërmerret masat në vijim:
  - 2.1. Vërejtja me gojë;
  - 2.1. Marrja e fjalës; dhe
  - 2.2. Largimi nga mbledhja.

#### **Neni 66**

##### **Shqiptimi i masave për mbajtjen e rendit në mbledhjet e PS/KS**

1. Vërejtje me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit nga kryetari i PS/KS, nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
2. Marrja e fjalës, nga kryetari i PS/KS i shqiptohet anëtarit të KS/PS, i cili me sjelljet dhe me deklaratat e tij çrregullon punën normale të KS/PS, për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje me gojë.
3. Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi t'i merret fjala pengon mbarëvajtjen e mbledhjes.
4. Largimin nga mbledhja e shqipton KS/PS me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

#### **Neni 67**

##### **Procesverbali nga mbledhja e KS / PS**

1. Në çdo mbledhje të KS / PS mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe procesmbajtësi.
2. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
  - 2.1. Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes;
  - 2.2. Rendin e ditës;
  - 2.3. Listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;

- 2.4. Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse;
  - 2.5. Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.
3. Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.
  4. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së KS/PS dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet anëtarëve të KS/PS me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të KS/PS.
  5. Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës të KS/PS.
  6. Procesverbali dhe materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës ruhen në arkiv të Universitetit si dokumente afatgjate. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së i dorëzohet nga një kopje e materialeve të mbledhjeve të PS.

#### **Neni 68**

##### **Procedura e votimit të fshehtë**

1. Procedura e votimit të fshehtë zbatohet nga komisioni i përbërë prej tre anëtarëve të caktuar nga PS / KS. Këta anëtarë zgjedhen me shumicën e thjeshtë të votave.
2. Pas votimit, kryetari konfirmon aprovimin apo refuzimin e propozimit bazuar në rezultatet e votimit.

#### **Neni 69**

##### **Rastet e votimit të fshehtë në PS**

1. Votimi me vota të fshehta në Parlamentin Studentor bëhet për:
  - 1.1. Zgjedhjen e studentëve senatorë në Senat;
  - 1.2. Zgjedhjen e kryetarit;
  - 1.3. Zgjedhjen e nënkryetarit;
  - 1.4. Shkarkimin e kryetarit;
  - 1.5. Shkarkimin e nënkryetarit;
  - 1.6. Shkarkimin e sekretarit;
  - 1.7. Çështjet që kanë ndikim në jetën private të një anëtari të parlamentit studentor;
  - 1.8. Çështjet për të cilat kkryetari kërkon të bëhen me votë të fshehtë;
  - 1.9. Çështjet për të cilat shumica absolute e anëtarëve kërkon votim të fshehur.
2. Numërimi i votave për këto çështje bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit të PS.

#### **Neni 70**

##### **Rastet e votimit të fshehtë në KS**

1. Votimi me vota të fshehta në Këshillin e Studentëve bëhet për:
  - 1.1. Nominimin e listës prej tre kandidatëve për anëtarë të Senatit nga radhët e studentëve;
  - 1.2. Zgjedhjen e kryetarit;
  - 1.3. Zgjedhjen e nënkryetarit;
  - 1.4. Shkarkimin i kryetarit;
  - 1.5. Shkarkimin e nënkryetarit;

- 1.6. Shkarkimin e sekretarit;
  - 1.7. Çështjet që kanë ndikim në jetën private të një anëtari të Këshillit të Studentëve;
  - 1.8. Çështjet për të cilat kryetari kërkon të bëhen me votë të fshehtë;
  - 1.9. Çështjet për të cilat shumica absolute e anëtarëve kërkon votim të fshehur.
2. Numërimi i votave për këto çështje do të bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit të KS.

### **Neni 71**

#### **Nominimet e listës së kandidatëve për anëtar të Senatit nga KS**

1. Nominimi i listës prej tre kandidatëve për anëtarë të Senatit bëhet në një mbledhje të vetme të KS.
2. Nuk mund të nominohen për anëtarë të Senatit, anëtarët e PS/KS pa dhënë dorëheqje nga funksioni që mbanë.
3. Për secilin kandidat të propozuar duhet të paraqitet një biografi e shkurtër.
4. Nëse ka më shumë se tre (3) kandidatë të propozuar, votimi mund të bëhet më së shumti për tre (3) kandidatë.
5. Fletëvotimet, të cilat përmbajnë më shumë se tre numra të kandidatëve të rrethuar konsiderohen të pavlefshme.
6. Tre kandidatët me numër më të madh të votave konsiderohen të nominuar dhe i përcillen PS për votim.
7. Në rast të votave të barabarta, organizohet radha e dytë e votimit për kandidatët me vota të barabarta, sipas rregullave të përshtatshme si më lart.
8. Nëse votat mbeten të barabarta edhe pas votimit në radhën e dytë, vendimi për nominimin e kandidatit bëhet përmes shortit.
9. Procedura e votimit udhëhiqet nga komisioni zgjedhor i përbërë prej tre (3) anëtarëve. Në përbërje të komisionit zgjedhor janë: sekretari i KS dhe dy (2) anëtarë tjerë të cilët zgjedhen nga KS me shumicë të thjeshtë të votave.
10. Anëtarë të komisionit zgjedhor nuk mund të zgjedhen kryetarët dhe nënkryetarët e KS.
11. Nëse nuk respektohen procedurat e specifikuar sipas këtij neni, Parlamenti i Studentëve nuk mund të procedoj me zgjedhje të anëtarëve të Senatit, gjithnjë duke u bazuar në marrëveshjen e deponuar sipas nenit 52 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 72**

#### **Zgjedhja e anëtarëve të Senatit nga Parlamenti i Studentëve**

1. Parlamenti i Studentëve zgjedh anëtarët e Senatit nga lista e të propozuarve nga Këshilli i Studentëve i fakultetit përkatës. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar ex-officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Senatit nga radhët e studentëve. Përveç kryetarit, PS i zgjedh për anëtarë e Senatit edhe gjashtë (6) studentë të tjerë në kuadër të numrit të

përgjithshëm, gjithnjë duke u bazuar në marrëveshjen e deponuar sipas nenit 52 të kësaj rregulloreje.

2. Studentët e zgjedhur për anëtarë të Senatit duhet të jenë studentë të dalluar me notë mesatare së paku tetë (8) dhe nuk duhet të jenë përsëritës të vitit akademik.
3. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Senatit nga radhët e studentëve duhet të dëshmohet përmes procesverbalit dhe fletëvotimeve, të cilat i dorëzohen Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit dhe ruhen në arkiv të Universitetit si dokumente afatgjate.

### **Neni 73 Komisionet e PS/KS**

1. Parlamenti i Studentëve dhe këshillat e studentëve, me kërkesë të organeve të Universitetit, përkatësisht të fakultetit, propozojnë studentë për të marrë pjesë në komisionet ndihmëse të këtyre organeve.
2. Anëtarët e komisioneve duhet të jenë studentë të dalluar me notë mesatare së paku tetë (8) dhe nuk duhet të jenë përsëritës të vitit akademik.
3. Komisionet e formuara nga PS/KS në pajtim me Statutin e Universitetit i ndihmojnë organet përkatëse të universitetit apo fakultetit për çështje të veçanta të punës së tyre.

### **Neni 74 Raporti në mes të PS dhe KS**

1. PS dhe KS kanë raporte të bashkëpunimit ndërinstytucional. PS konsiderohet organ epror dhe mund të kërkojë llogari për punën e KS në kuadër të njësisive akademike.
2. PS dhe KS mund të kenë takime të rregullta vjetore, me qëllim të ushtrimit të kompetencave të tyre.
3. Për nevoja të punës mund të themelohet kolegji i kryetarëve të KS. Ky kolegji themelohet me vendim të PS dhe udhëhiqet nga kryetari i PS. Kolegji i kryetarëve ka funksion konsultativ, me qëllim të koordinimit të punëve në mes të PS dhe KS.

### **Neni 75 Raporti i PS dhe KS me organet e Universitetit/Fakultetit**

1. PS dhe KS, përfshirë edhe kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarin ushtrojnë funksionet e tyre duke kultivuar frymën e bashkëpunimit me organet e Universitetit dhe Fakultetit.
2. PS dhe KS përfshirë edhe kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarin në komunikim me organet e Universitetit dhe fakultetit duhet të përdorin sjellje dhe gjuhë të pranueshme dhe institucionale. Ndalohet përdorimi i gjuhës paragjykuese, denigruese, fyese, shpifëse dhe jo-institucionale. Përdorimi i kësaj gjuhe në komunikim me organet e Universitetit dhe Fakultetit nga kryetari, nënkryetarët, sekretari dhe anëtarët e PS/KS konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe trajtohet si e tillë.



## Neni 76

### Qasja ndaj resurseve të PS dhe KS

1. PS/KS kanë të hapura emailat zyrtar të organeve, nën domentin @uni-pr.edu. Qasje në emailin zyrtar të PS/KS duhet të kenë kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i PS/KS. Përdorimi i emailit të PS/KS duhet të bëhet me një konsultim paraprak të kryetarit, nënkryetarëve dhe sekretarit të PS/KS.
2. Kryetari i PS/KS nuk mund të transmetojë përmes emailit të PS/KS vendime të PS/KS, pa konsultimin paraprak të anëtarëve.
3. Në emailin e PS/KS nuk mund të kenë qasje persona të paautorizuar. Qasja e personave të paautorizuar në emailin zyrtar të PS/KS do të trajtohet si shkelje e rëndë disiplinore ndaj kryetarit, nënkryetarëve dhe sekretarit të PS/KS.
4. PS/KS mund të hapin llogaritë e tyre të autorizuara në rrjete sociale (facebook, instagram dhe twitter dhe tjera). Qasje në llogaritë në rrjete sociale duhet të kenë kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i PS/KS. Llogaritë në rrjete sociale duhet të hapen me vendim të PS/KS.
5. Pas përfundimit të mandatit të PS/KS, qasja në emailat dhe llogaritë në rrjete sociale duhet t'i bartet PS/KS së re. Në të kundërtën do të iniciohet procedurë disiplinore për shkelje të rëndë dhe procedurë tjetër pranë organeve kompetente ndaj personave përkatës që kanë qasje në emailin zyrtar dhe llogaritë përkatëse në rrjete sociale të PS/KS.
5. Postimi dhe shprehja në rrjetet sociale (facebook, instagram, twitter) të cilat nuk janë llogari zyrtare të PS dhe KS (të themeluara sipas vendimit të PS/KS), konsiderohet dhe trajtohet si shkelje e rëndë disiplinore. Procedura iniciohet ndaj personit që bën postimin si dhe ndaj atyre të cilët kanë krijuar dhe mirëmbajnë llogarinë në rrjete sociale dhe e cila nuk është e autorizuar nga PS/KS.
6. Qasje në vulën e PS/KS kanë kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i PS/KS kurse qasje në asetet e tjera të PS/KS, përfshirë edhe zyrën kanë të gjithë anëtarët të cilët janë pjesë e marrëveshjes, sipas nenit 52. Ndalimi i qasjes në zyrë konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe trajtohet si e tillë. Zyrën e KS/PS e administrojnë kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i PS/KS.
7. Ndalohet qasja e personave të cilat nuk janë anëtarë të PS/KS në zyrën dhe asetet e PS/KS. Në rast të qasjes në asetet e PS/KS të personave të paautorizuar do të iniciohet procedurë disiplinore për shkelje të rëndë ndaj personave që kanë këtë qasje të pa autorizuar, si dhe ndaj kryetarit të PS/KS. Situata e tillë konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore.

## Neni 77

### Sistemi elektronik i votimit

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, UP duhet të krijojë sistemin elektronik të votimit për zgjedhje studentore.
2. Sistemi elektronik i votimit në zgjedhjet studentore konsiderohet resurs i Universitetit dhe i njëjti mirëmbahet nga Universiteti i Prishtinës, respektivisht nga personat kompetentë të zyrës së TI-së.

3. Me qëllim të aplikimit sa më të lehtë të sistemit elektronik të votimit, KQZ-UP mund të nxjerr udhëzues në bashkëpunim me zyrën e TI-së së Universitetit të Prishtinës.

### **Neni 78 Zbatimi i rregullores**

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, KQZ UP nxjerr udhëzues dhe vendime.
2. Udhëzimet dhe vendimet e KQZ UP publikohen në ueb faqen zyrtare të KQZ UP-së.
3. KQZ UP ka emailin e zyrtar, përmes të cilit komunikon me palët e brendshme dhe të jashtme.

## **Kapitulli IV**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 79 Vlefshmëria, zbatimi dhe ndryshimi**

1. Për çështjet të cilat nuk janë paraparë dhe nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë këtë fushë, si dhe dispozitat e Statutit të UP-së. Në rast konflikti të ndonjë dispozite të kësaj rregullore, vlejné dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe të Statutit.
2. Për të gjitha çështjet lidhur me vendimet apo procedurat e kontestuara në lidhje me këtë Rregullore, Këshilli Drejtues i UP-së do të marrë vendim përfundimtar.
3. KQZ-UP/KZF, PS dhe KS përkatëse janë përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
4. Interpretimi autentik të kësaj rregulloreje e bën Këshilli Drejtues.
5. Kjo rregullore plotësohet dhe ndryshohet në procedurën e njëjtë.
6. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe skema zgjedhore e përfaqësimit të studentëve e bashkangjitur në shtojcë.

#### **Neni 80 Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja me nr. prot. 1/55, datë 12.5.2022 për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe këshillave të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
2. PS dhe KS janë të obliguar që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i rishikojné dhe harmonizojné vendimet e tyre, sipas kësaj rregulloreje.
3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, në afat prej 15 ditës, PS dhe KS, duhet që me vendim të përcaktojnë emailat e tyre zyrtare si dhe llogaritë zyrtare në Facebook dhe rrjete

tjera sociale. Llogaritë e tjera të hapura në emër të PS/KS të cilat nuk përcaktohen me vendim të PS/KS konsiderohen si llogari të paautorizuara.

**Neni 81**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i UP-së.



Alfin Sahiti

Kryesues i Këshillit Drejtues

**SHTOJCA 1**  
**Skema zgjedhore e përfaqësimit të studentëve**

